Tatjana Atanasovska-Paçemska
Violeta Popovska
Dobri Jovevski

MATEMATIKA PËR KLASËN E TRETË

Matematika për klasën e tretë

Autorë
Tatjana Atanasova-Paçemska
Violeta Popovska
Dobri Jovevski

Recensentë
Beti Andonoviq
Silvana Rusu
Sonja Trifunovska

Titulli origjinal:
Математика за трето одделение
Татјана Атанасова-Пачемска
Виолета Поповска
Добри Јовевски

Redaktor: Refail Sulejmani

Përkthyer nga gjuha maqedonase: Muzafer Beqiri

Redaktor profesional i botimit në gjuhën shqipe: Xhevair Beqiri

Lektor: Refail Sulejmani

Ilustrtues:
Elizabeta Angjellova Shurbevski, Shenol Ali, Anita Milevska, Teodora Jovanovska

Rregullimi grafik dhe teknik: Vladimir Mladenovski, Vesna Depinovska – ARS STUDIO

Botues: Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut
rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, 1000 Shkup

Shtypi: Evropa 92 – Koçan

Tirazhi: 6640

Vendi dhe viti i botimit: Shkup, 2023

Me vendimin për lejimin e tekstit shkollor nga lënda Matematika për klasën e tretë nr. 26-2325/1 të datës 18.10.2023 të sjellë nga Komisioni kombëtar për tekste shkollore.

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

373.3.016:51(075.2)=18

ATANASOVSKA-Paçemska, Tatjana
Matematika për klasën e tretë / Tatjana Atanasovska-Paçemska, Violeta Popovska, Dobri Jovevski ; [përkthyer nga gjuha maqedonase Muzafer Beqiri ; ilustrtues Elizabeta Angjellova Shurbevski ... и др.]. - Shkup : Ministria e Arsimit dhe Shkencës e Republikës së Maqedonisë së Veriut, 2023. - 237 стр. : илустр. ; 27 см

Превод на делото: Математика за трето одделение / Татјана Атанасова-Пачемска, Виолета Поповска, Добри Јовевски. - Други илустратори: Shenol Ali, Anita Milevska, Teodora Jovanovska

ISBN 978-608-273-647-1

1. Popovska, Violeta [автор] 2. Jovevski, Dobri [автор]

COBISS.MK-ID 62485509

Të dashur nxënës të klasës së tretë!

Mirë se erdhët në botën e matematikës. Ky është teksti juaj i matematikës që do ta shfrytëzoni në klasën e tretë. Ky tekst ju mundëson zhvillimin e aftësive për të menduar dhe strategjitë se si t'i zgjidhni problemet matematikore hap pas hapi.
Ju Inkurajojmë të jeni të angazhuar, të mësoni dhe të zbuloni, ta duani matematikën dhe ta praktikoni atë që e mësoni në jetën tuaj të përditshme. Detyrat do t'i zgjidhni në shtëpi ose në shkollë, kurse gjithmonë përpiquni gjithë atë ta bëni në mënyrë të pavarur, pasi në atë mënyrë më së miri do ta kuptoni, kurse kjo do t'u sjellë rezultat dhe kënaqësi.
Ju dëshirojmë sukses në shoqërimin me këtë tekst të matematikës për klasën e tretë!

Nga autorët

Udhëzues nëpër matematikën

Nëpër faqet e tekstit do të vëresh simbole të cilat tregojnë në llojet specifike të aktiviteteve.

ÇFARË DO TË MËSOHET NË KLASËN E TRETË



Nëse bën 10 grupe prej 100 sendeve e ka paraqitur numrin njëmijë, i cili shkruhet me katër shifra 1 000

Do të mësosh të lexosh dhe shkruash drejt numrat deri 1 000, të krahasosh çifte prej numrave treshifrorë dhe ta caktosh vlerën vendore të shifrave te numrat treshifrorë.



Cila formë 3D ka 12 tehe, 6 faqe dhe 8 kulme?

Do të përshkruani format 2D dhe 3D, do të gjeni ngjashmëri dhe ndryshime ndërmjet tyre.
Sfida do të jetë përcaktimi i numrit të brinjëve, kulmeve dhe këndeve te format 2D dhe faqet, kulmet dhe tehet te format 3D.

Mbledhësit,
shuma,
i zbritshmi,
zbritësi,
ndryshimi

Në këtë temë nëpërmjet mënyrave të ndryshme do t'i zgjerojmë dhe do t'i thellojmë njohuritë dhe aftësitë të mblidhni. zbritni, shumëzoni dhe pjesëtoni.

Sa denarë ka kursyer Ema?

Në këtë temë do të jeni hulumtues, do të matni: gjatësi, masë, vëllim, do t'i vlerësoni sa kohë është e nevojshme për aktivitetet tuaja.
Do të mësoni të jeni "tregtarë" të mirë dhe të kurseni!

Cilat të dhëna dhe informata na janë të nevojshme? Si do t'i fitojmë? Si do t'i paraqesim? Çfarë do të përgjigjemi?

Sfida në këtë temë do të jetë e planifikuar dhe realizoni hulumtim. Të dhënat të paraqiten me tabela të dendësisë, piktograme, diagrame shtyllore, diagram të Kerolovit ose të Venit.

PËRMBAJTJA

NUMRAT DHE NUMËRIMI

NUMRAT DERI 100 – PËRSËRITJE 10
LEXIMI DHE TË SHKRUARIT E NUMRAVE DERI 1 000 12
NUMËRIMI PËRPARA DHE PRAPA NGA 1, NGA 10 DHE NGA 100 DERI 1 000 16
NUMËRIMI NGA DY, NGA TRE, NGA KATËR, NGA PESË, NGA GJASHTË, NGA NËNTË DHE NGA DHJETË GRUPE MË TË MËDHA TË SENDEVE DERI TE MË SË PAKU 100 18
BËRJA E VLERËSIMIT PËR NUMËR TË SENDEVE 21
VENDOSJA E NUMRAVE TRESHIFRORË TE DREJTËZA NUMERIKE TEK E CILA JANË SHËNUAR DHJETËSHET DHE QINDËSHET E PLOTA 23
CAKTIMI I VLERËS VENDORE TË SHIFRAVE TE NUMRI TRESHIFROR 26
ZBËRTHIMI I NUMRIT TRESHIFROR NË QINDËSHE, DHJETËSHE DHE NJËSHE 29
RRUMBULLAKIMI 31
NUMRAT DYSHIFRORË DERI TE DHJETËSHJA MË E AFËRT 31
NUMRAT TRESHIFRORË DERI TE DHJETËSHJA DHE QINDËSHJA MË E AFËRT 31
KRAHASIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË, DUKE SHFRYTËZUAR, DUKE PËRDORUR SHENJAT “>“, “=“ DHE “<“ 33
RENDITJA E NUMRAVE DYSHIFRORË DHE TRESHIFRORË DERI 1 000 35
VLERËSIMI I VENDIT TË NUMRIT NDËRMJET QINDËSHEVE TE DREJTËZA NUMERIKE 37
TË SHPREHURIT DHE TË SHKRUARIT E NUMRAVE RRESHTORË MË SË PAKU DERI TE NUMRI I NJËQIND 39
NJOHJA DHE EMËRTIMI I NUMRAVE ÇIFT DHE TEK DERI 1 000 41
FORMIMI I VARGUT PREJ NUMRAVE PËR DY MË TË MËDHENJ OSE PËR DY MË TË VEGJËL PREJ NUMRIT TË DHËNË DERI 1 000 43
PËRSËRITJE, USHTROJMË 45

GJEOMETRIA

SEGMENTI 47
FORMAT 2D 50
NJOHJA DHE EMËRTIMI I FORMAVE 2D 50
SHËNIMI DHE EMËRTIMI I KULMIT DHE BRINJËS SË FORMAVE 2D 52
NJOHJA E KËNDIT TË DREJTË TE FORMAT 2D 55
FORMAT 2D SIPAS NUMRIT TË BRINJËVE 57
FORMAT 3D 58
NJOHJA DHE EMËRTIMI I FORMAVE 3D 58
ELEMENTET E FORMAVE 3D 60
ELEMENTET E PRIZMIT – KULMI, TEHU DHE FAQJA 60
PËRCAKTIMI I FAQEVE, TEHEVE DHE KULMEVE TE FORMAT 3D 63
LIDHJA E FORMAVE 2D ME RRJETAT E FORMAVE 3D 65
VIJA E SIMETRISË DHE SIMETRIA TE RRETHINA 66
NJOHJA DHE VIZATIMI I VIJAVE TË SIMETRISË TE FORMAT 2D 66
POZITA, KAHJA DHE LËVIZJA 70
PËRCAKTIMI I POZITËS TE RRJETA E KATRORIT 70
LËVIZJA E OBJEKTEVE SIPAS KAHJES SË DHËNË TE RRJETA E KATRORIT 74
PËRSËRITJE, USHTROJMË 76

OPERACIONET ME NUMRA

MBLEDHJA E QINDËSHEVE DERI 1 000 79
MBLEDHJA E NUMRAVE TRESHIFRORË ME DHJETËSHE DHE QINDËSHE TË PLOTA .. 82
PËRCAKTIMI I NUMRIT MË TË MADH MË TË VOGËL PËR 1, 10, 100 PREJ NUMRIT TRESHIFROR 85
MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR, DYSHIFRORË DHE TRESHIFRORË DERI 1 000 PA KALIM 87
MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR, DYSHIFRORË DHE TRESHIFRORË DERI 1 000 ME KALIM 93
VETIA KOMUTATIVE 102
ZBRITJA E QINDËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000 104
ZBRITJA E QINDËSHEVE TË PLOTA PREJ NUMRIT TRESHIFROR 106
ZBRITJA E DHJETËSHEVE TË PLOTA PREJ NUMRIT TRESHIFROR 108
ZBRITJA E NUMRIT NJËSHIFROR, DYSHIFRORË DHE TRESHIFRORË PREJ NUMRIT TRESHIFROR 110
PËRCAKTIMI I NUMRIT TË PANJOHUR GJATË MBLEDHJES DHE ZBRITJES DERI 1 000 113
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE ME MBLEDHJE DHE ZBRITJE TË NUMRAVE DERI 1 000 116
DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI I NUMRAVE DERI 1 000 118
DYFISHIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ QINDËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000 118
PËRGJYSMIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ QINDËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000 120
DYFISHIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ DHJETËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000 122
PËRGJYSMIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ DHJETËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000 124
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 DHE 10 126
SHUMËZIMI I NUMRIT NJËSHIFRORË ME 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 DHE 10 126
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 1 129
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 2 130
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 4 131
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 5 132
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 10 133
VAZHDOJMË ME SHUMËZIM DHE PJESËTIM 134
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 3 134
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 6 137
SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 9 140
SHUMËZIMI I NUMRIT DYSHIFRORË ME 10 143
SHUMËZIMI I NUMRAVE PREJ DHJETËSHES SË DYTË ME 1, 2, 3, 4 DHE 5 145
SHUMËZIMI ME NUMËR NJËSHIFROR ME KALIM 147
VETIA KOMUTATIVE E SHUMËZIMIT 149
NJOHJA E NUMRAVE DYSHIFRORË DHE TRESHIFRORË TË FITUAR ME SHUMËZIMIN ME 2, 5 DHE 10 151
LIDHJA NDËRMJET SHUMËZIMIT DHE PJESËTIMIT 153
PJESËTIMI I NUMRIT DYSHIFRORË ME NUMËR NJËSHIFROR ME MBETJE 154
CAKTIMI I NUMRIT TË PANJOHUR GJATË SHUMËZIMIT DHE PJESËTIMIT 158
ZGJIDHJA E DETYRAVE TEKSTUALE 161

THYESA 163
NJOHJA E PJESËVE PREJ TË PLOTËS 163
TË SHKRUARIT E PJESËVE PREJ TË PLOTËS 165
BARAZIA E THYESAVE 167
PARAQITJA E THYESAVE TE FORMAT 2D DHE GRUPI I SENDEVE DERI 100 168
PËRSËRISIM, USHTROJMË 170

MATJA

PARATË 173
NJOHJA, EMËRTIMI DHE GRUPIMI I MONEDHAVE DHE BANKNOTAVE DERI 1 000 173
CAKTIMI I SHUMËS SË SAKTË TË PARAVE 175
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE – PARATË 176
GJATËSIA 177
MATJA E GJATËSISË – METRI, CENTIMETRI 177
MATJA E GJATËSISË – DECIMETRI 180
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE – GJATËSIA 183
MASA 184
MATJA E MASËS – KILOGRAMI, GRAMI 184
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE – MASA 188
VËLLIMI 189
MATJA E LËNGJEVE – LITRI, DECILITRI 189
ZGJIDHJA E SITUATAVE PROBLEMORE – VËLLIMI 191
KOHA 192
LEXIMI I KOHËS NË ORË, MINUTA DHE SEKONDA 192
MUAJI, VITET, DEKADAT 195
ZGJIDHJE DETYRASH – KOHA 197

PUNA ME TË DHËNA

LEXIMI I TË DHËNAVE 199
MBLEDHJA, RREGULLIMI DHE PARAQITJA E TË DHËNAVE 203
CAKTIMI I VLERËS VENDORE TË NUMRAVE DERI 1 000 ME SHIGJETA 211
TABELAT DERI 1 000 212
TABELAT DERI 1 000 213
FAQJA PREJ THYESAVE 215
SHEMBUJ 217
PËR THYESA 217
PARAQITJA GRAFIKE E NJËSHEVE, DHJETËSHEVE, QINDËSHEVE DHE MIJSHEVE 219
FORMAT 2D 221
FORMAT 2D 222
FORMAT 3D 223
TABELA SHUMËZIMI TABELAR DERI 100 225
ORA 227
PARATË E MAQEDONISË – DENARËT 229
BANKNOTAT 230
MONEDHAT 230
INSTRUMENTET MATËSE PËR MASËN, GJATËSINË DHE VËLLIMIN 231

NUMRAT DHE NUMËRIMI

Rezultatet nga të mësuarit. Nxënësi:

- numëron, lexon dhe shkruan numra deri 1 000;
- krahason çifte prej numrave treshifrorë dhe e cakton vlerën vendore të shifrave te numrat treshifrorë;
- njeh dhe shfrytëzon numra rendorë deri më së paku te numri njëqind;
- grumbullon numra çift dhe tek deri 1 000.

Përmbajtjet:

- Numra deri 1 000
- Vlera vendore e shifrave
- Krahasimi i çifteve prej numrave treshifrorë
- Numra rendorë
- Numra çift dhe tek

Fjalori i koncepteve të reja

- numër
- shifër
- sasi
- njëshe
- dhjetëshe
- qindëshe
- mijëshe
- vlera vendore
- numra rendorë
- numra çift
- numra tek

NUMRAT DERI 100 – PËRSËRITJE

1 **Lidhi numrat në pajtim me kërkesat:**







1. Lidhi sipas renditjes numrat, duke filluar prej 1.

Cilin numër e fitove?

_____

2. Lidhi sipas renditjes numrat prej dhjetëshes së pestë.
Pastaj lidhi prej numrit më të vogël dhe më të madh prej dhjetëshes së pestë.

3. Lidhi sipas renditjes numrat prej dhjetëshes së nëntë.
Pastaj lidhe edhe numrin më të vogël dhe më të madh prej dhjetëshes së pestë.

2 **Lexoji dhe shkruaji numrat me fjalë.**



3 **Gjeji këta numra te tabela duke lëvizur në kahjen përpara-prapa, lart-poshtë ose majtas-djathtas.**

- pesëdhjetë e pesë
- njëzet e tre
- pesëmbëdhjetë
- tetëdhjetë e pesë
- trembëdhjetë
- nëntëdhjetë e shtatë
- dyzet e katër

2	0	9	0	1	7	5	9
1	4	5	4	8	9	0	0
1	3	6	9	6	2	2	6
4	0	7	4	5	3	0	7
9	4	4	2	5	0	5	0
6	0	9	6	9	6	8	9
2	2	0	1	4	0	8	2
1	4	8	9	7	6	1	5

4 Krahasoji numrat! Vendose shenjën e nevoshme: > = < .

54 ◯ 29	33 ◯ 33	59 ◯ 87	53 ◯ 48
97 ◯ 55	47 ◯ 89	55 ◯ 86	20 ◯ 77
62 ◯ 32	49 ◯ 72	26 ◯ 21	3 ◯ 10

5 Vëreje rregullën dhe plotësoji vargjet me numrat të cilët mungojnë.





6 Shkruaje:

a) numrin çift më të madh prej dhjetëshes së katërt,

b) numrin tek më të vogël prej dhjetëshes së tretë,

c) pasardhësin e numrit më të madh prej dhjetëshes së dytë,

ç) paraardhësin e numrit më të vogël treshifror.



7 Njehso:

39 + 17 = ☐	69 − 29 = ☐	25 + 35 = ☐	79 − 73 = ☐	86 − 58 = ☐
54 − 21 = ☐	38 + 43 = ☐	81 − 32 = ☐	32 − 28 = ☐	65 − 32 = ☐

8 Shumëzo me 5 dhe 2 dhe shkruaji rezultatet e fituara te rrathët përkatës.



9 Gjendeni te fusha e futbollit ku dy ekipe luajnë futboll.
Udhëzim: Sa futbollistë ka çdo ekip i futbollit?
Përpiloni detyrë tekstuale tek e cila do ta përdorni operacionin pjesëtim dhe pastaj zgjidhni.

LEXIMI DHE TË SHKRUARIT E NUMRAVE DERI 1000

Të përkujtohemi!

Cili numër është paraqitur te numratorja?

Numri i paraqitur i shkruar me shifrat **46**, kurse me fjalë **dyzet e gjashtë**.



$10 \cdot 100 = 1\,000$
$10 \cdot 1\,Q = 10\,Q = 1\,M$



100	njëqind
200	dyqind
300	treqind
400	katërqind
500	pesëqind
600	gjashtëqind
700	shtatëqind
800	tetëqind
900	nëntëqind
1 000	njëmijë

Të përkujtohemi!



Numri i paraqitur i shkruar me shifra është **383**, kurse me fjalë **treqind e tetëdhjetë e tre**.

Numrat të cilët përmbajnë dhjetëshe dhe njëshe shkruhen me dy shifra dhe quhen **numra dyshifrorë**.
Numrat të cilët përmbajnë qindëshe, dhjetëshe dhe njëshe shkruhen me tri shifra dhe quhen **numra treshifrorë**.
Së pari lexohen qindëshet, pastaj dhjetëshet dhe njëshet.
Numri 1 000 përmban 10 qindëshe, shkruhet me katër shifra. Ai është numri më i vogël katërshifror (i pari).

Sa lapsa ka te figura?



Çdo laps ta zëvendësojmë me kub dhe ta paraqesim. Formuam grup prej kubeve.



Një grup prej 100 kubeve paraqet një qindëshe. Shkruajmë 1 Q
Një grup prej 10 kubeve paraqet një dhjetëshe dhe shkruajmë 1 DH
Grupi prej 2 kubeve të cilat nuk formojnë dhjetëshe paraqesin 2 njëshe, 2 NJ.

Ka gjithsej 112 kube. Shkruajmë me numrin 112.
Lexojmë: një qind e dymbëdhjetë

1 Shkruaji numrat të cilët janë paraqitur te numratorja.



2 Lidhi figurat me numrin që e paraqesin.



306

230

154

262

320

226

3 Shkruaji qindëshet e plota më të mëdha se 300, kurse më të vogla se 1 000.



4 Shkruaji numrat sipas domethënies së simboleve:

1 10 100

	Shkruaj	Lexoj
	362	treqind e gjashtëdhjetë e dy
		
		

5 Shkruaji tre numra të cilët gjenden ndërmjet numrave:

a) 195 dhe 205

b) 637 dhe 644

c) 892 dhe 902

6 Prej shifrave të dhëna formo numra treshifrorë pa përsëritje të shifrave.

6 2 9	4 1 8	7 3 5
629		
692		

Dhjetëshe të plota prej çdo qindëshe deri 1 000

10	20	30	40	50	60	70	80	90	100	← qindëshja e parë
110	120	130	140	150	160	170	180	190	200	← qindëshja e dytë
210	220	230	240	250	260	270	280	290	300	← qindëshja e tretë
310	320	330	340	350	360	370	380	390	400	← qindëshja e katërt
410	420	430	440	450	460	470	480	490	500	
510	520	530	540	550	560	570	580	590	600	
610	620	630	640	650	660	670	680	690	700	
710	720	730	740	750	760	770	780	790	800	
810	820	830	840	850	860	870	880	890	900	
910	920	930	940	950	960	970	980	990	1 000	

7 **Me shifrat 6, 3 dhe 7 (pa u përsëritur ato) shkruaji të gjithë numrat treshifrorë:**

a) prej qindëshes së katërt _____

b) prej qindëshes së shtatë _____

c) prej qindëshes së tetë _____

8 **Shkruaji nga disa numra me dhjetëshe të plota në pajtim me kërkesat:**

qindëshja e tretë

dhjetëshja e pestë prej qindëshes së gjashtë

dhjetëshja e katërt dhe e nëntë prej qindëshes së nëntë

dhjetëshja e parë dhe e fundit prej qindëshes së tetë

9 **Numri 111 është numër treshifror i cili shkruhet vetëm me shifrën 1. Shkruaji të gjithë numrat treshifrorë të cilët shkruhen me tri shifra të njëjta. Lexoji!**

10 **Lidhi numrat e barabartë të shkruar me shifrat dhe me fjalë.**



- nëntëqind e tetëdhjetë
- njëqind e pesëdhjetë e tre
- gjashtëqind e gjashtëdhjetë
- gjashtëqind e gjashtëmbëdhjetë
- dyqind e gjashtëdhjetë e katër
- pesëqind e tridhjetë e një



NUMËRIMI PËRPARA DHE PRAPA NGA 1, NGA 10 DHE NGA 100 DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Eja të numërojmë?

1, 2, 3, ...
10, 20, 30,...
100, 200, 300, ...
550, 540, 530,...
617, 618, 619, ...

Numërojmë në renditje rritëse dhe zvogëluese.
Kur numrat i rendisim prej më të voglit kah më i madh, themi se anë renditur në renditje rritëse.
Kur numrat i rendisim prej më të madhit kah më i vogli, themi se janë renditur në renditje zvogëluese.



1 **Shkruaji numrat që mungojnë, duke numëruar në renditje rritëse ose zvogëluese:**

104				108					113
540			537						
934							941		
701	700								

2 **Vazhdo këto vargje sipas rregullave të dhëna.**

Numëro përpara. Numëro prapa.

10

356									446		

10

381							451				491

10

523						583					

10

								617			647

10

668						728					

3 **Plotësoje tabelën me vargje duke vijuar instruksionet e dhëna te rreshti i parë.**

	+ 10	− 1	+ 100	− 10
156				
254	264			353
313				
467		476	576	
581				
625				
619				
747				
832				

4 Duke i përcjell kahjet gjeji dhe shkruaji numrat që duhet të qëndrojnë te katrorët e zbrazët.



5 Numrin 761 shkruaje te lokomotiva e trenit dhe vazhdo të numërosh prapa nga 100. Shkruaji numrat e kërkuar te vagonët në renditje zvogëluese.

6 Plotësoji tabelat me numrat të cilët mungojnë duke numëruar nga 1. Mund të plotësosh në kahje të ndryshme dhe në lëvizje nëpër tabelë! Fillo prej ndonjërit prej numrave të shënuar.

									410
								419	
							428		
						437			
					446				
				455					
			464						
		473							
	482								
491									

			604			607			
		613					618		
	622							629	
631									640
661									670
	672							679	
		683					**688**		
			694			697			

7 Te tabela e qindëshes së tetë përshkruaji numrat që mungojnë, kurse pastaj ngjyros fushat (drejtkëndëshat):

a) të cilët shkruhen me shifrat 7, 2 dhe 3 me ngjyrë të kuqe (shifrat mund të përsëriten)

b) me ngjyrë të verdhë te të cilët shuma e shifrave është më e madhe se 20.

701	702	703	704	705					
	712			715					
		723		725					
			734	735					
				745					
				755	756				
				765		767			
				775			778		
				785				789	
				795	796	797	798	799	800

NUMËRIMI NGA DY, NGA TRE, NGA KATËR, NGA PESË, NGA GJASHTË, NGA NËNTË DHE NGA DHJETË GRUPE MË TË MËDHA TË SENDEVE DERI TE MË SË PAKU 100

Të përkujtohemi!

Që më lehtë të numërojmë grup më të madh të sendeve, i grupojmë në grupe më të vogla.



Nga sa topa ka në çdo grup?

_____

Sa topa ka gjithsej?

_____

1 **Përshkruaji vargjet sipas rregullës së dhënë.**



2 **Numëro sa lëpirëse dhe kulaçe ka te grupet. Që më lehtë të numërosh, lëpirëset grupoji nga 3 në grup, kurse kulaçet nga 6 në grup.**

Lëpirëse ka

___ grupe · ___ = ___

Kulaçe ka

___ grupe · ___ = ___

3 **Vazhdo me vargjet.**



4 **Zbulo rregullën dhe vazhdoji vargjet.**



Rregulla është _____



Rregulla është _____

Rregulla është _____

Rregulla është _____

Rregulla është _____

Rregulla është _____

5 **Fillo vargun dhe vijo instruksionet e formimit!**



6 **Ana i ka numëruar paratë e kursyera prej arkës së saj. Ka pasur 5 banknota prej nga 100 denarë, 5 monedha prej nga 10 denarë, 7 monedha prej nga 2 denarë. Mbaroji vargjet sikurse ke filluar.**
Sa denarë ka kursyer Ana?





Ana ka kursyer _____ denarë.

7 **Zbulo rregullën për formimin e çdonjërës prej vargjeve.**

a) 850, 853, 856, 859 Rregulla është _____

b) 460, 454, 448, 442 Rregulla është _____

c) 524, 531, 538, 545 Rregulla është _____

ç) 610, 601, 592, 583 Rregulla është _____

8 **Zbuloji numrat të cilët i fshehin kafshët.**
Shkruaji te katrorët.

500		510	515		525	530	
540			555		565	570	
580				600	605		615
	625	630			645	650	655
	665	670		680		690	695



BËRJA E VLERËSIMIT PËR NUMËR TË SENDEVE

Të përkujtohemi!

Sa topa ka te thesi?

Mund të supozojmë, të vlerësojmë. Por për të ditur saktë sa ka, është e nevojshme të numërojmë.

Kur bën vlerësim, pa zgjidhur, kërkon përgjigje që është e mjaftueshme afër deri tek e sakta.

1 **Të supozojmë! Sa fasule ka te çdo kavanoz?**



10 13 12 17 15 16 17 15 16

Me numërim kontrollo sa shmang prej vlerësimit. Rrethoje numrin e saktë të fasuleve te kavanozët.

2 **Vlerëso sa sende ka në çdonjërën prej figurave. Pastaj bëj grupe prej nga 2, 3, 4, 5, ose 10 sende dhe kontrollo vlerësimin tënd. Shkruaje numrin.**

a)

Njehsimi:

b)

Njehsimi:

c)

Njehsimi:

ç)

Njehsimi:

3 **Për çdo figurë shkruaj fjali tek e cila do të përdorësh një numër ndërmjet numrave 100 dhe 1 000. Vlerëso!**



Shembulli: Në kuti ka 160 dredhëza.

_____

_____

_____

_____

VENDOSJA E NUMRAVE TRESHIFRORË TE DREJTËZA NUMERIKE TEK E CILA JANË SHËNUAR DHJETËSHET DHE QINDËSHET E PLOTA

Të përkujtohemi!

Maria ka dëshiruar ta lexojë temperaturën prej termometrit dhe ta paraqesë te drejtëza numerike.
T'i ndihmojmë Marisë!

Mbaj mend!
Numrat mund të paraqiten si pika prej drejtëzës. Çdo numri i përgjigjet një pike dhe anasjelltas çdo pikë i përgjigjet një numër. Drejtëza tek e cila janë paraqitur numrat quhet **drejtëza numerike.**



1 **Te drejtëza numerike cakto dhe shkruaji numrat të cilët janë shënuar me viza.**

2 **Plotësoji drejtëzat numerike me numra të cilët mungojnë.**



3 Te fushat e zbrazëta shkruaji numrat të cilët mungojnë.

a)



b)



4 Shkruaji numrat të cilët i tregojnë shkronjat A, B, C.





A është _____

B është _____

C është _____

5 Te fushat e zbrazëta shkruaji numrat të cilët i tregojnë shigjetat.



6 Numrat prej tabelës paraqiti te drejtëza numerike.

591	528	540	439	484
463	422	539	578	435



7 **Shigjetat i lidhin figurat e ngjyrosura me numra të drejtëzës numerike.**



Te tabela shkruaji numrat të cilët u përgjigjen figurave të ngjyrosura.

	○	△	▭

8 **Cakto paraardhësin dhe pasardhësin e numrave.**



9 **Plotësoji fjalitë me fjalët "paraardhës" ose "pasardhës".**

a) Numri 678 është _____ i numrit 679.

b) Numri 390 është _____ i numrit 389.

c) Numri 999 është _____ i numrit 1 000.

ç) Numri 621 është _____ i numrit 620.

CAKTIMI I VLERËS VENDORE TË SHIFRAVE TË NUMRIT TRESHIFROR

Të përkujtohemi!

Cili numër është paraqitur te numratorja?



Te numratorja është paraqitur numri 24.

2 është në vendin e dhjetësheve dhe ka vlerë vendore 20.

4 është në vendin e njësheve dhe ka vlerë vendore 4.

Vlera vendore e një shifre cakto-het sipas vendit të saj te shënimi i numrit.

Te numri 55 cakto vlerën vendore të shifrës 5.

Numrat te katrorët paraqiti te numratoret.



Zbulo si është paraqitur numri 143!

njëqind e dyzet e tre



1 **Sipas shembullit, plotëso për numrin 238.**



Mbaj mend!

Te cili numër shifra 3 ka vlerë vendore më të madhe?

143 ose **238**

Shifra 3 ka vlerë më të madhe te numri **238** pasi është në vendin e dhjetësheve.

Shifra 3 te numri **143** ka vlerë 3 njëshe.

Vlera e shifrës te një numër varet prej vendit të tij tek ai numër.

2 **Sipas shembullit, plotëso për numrin 1 000.**



1 000 = 1 M
1 000 = 10 Q
1 000 = 100 DH
1 000 = 1 000 NJ
1 M = 10 Q = 100 DH = 1 000 NJ

3 **Cakto shifrën e qindësheve, dhjetësheve dhe njësheve te këta numra:**



4 **Shkruaje vlerën vendore të shifrës së nënvizuar te çdo numër.**

264	283	425
282	323	684
749	965	473

5 **Plotësoji fjalitë:**

a) Numri 731 ka 7 qindëshe, 73 dhjetëshe dhe 731 njëshe.
b) Numri 390 ka _____, _____ dhe _____.
c) Numri 405 ka _____, _____ dhe _____.
ç) Numri 247 ka _____, _____ dhe _____.
d) Numri 999 ka _____, _____ dhe _____.

6 **Shkruaje numrin i cili ka shifra me vlerë vendore:**

a) 3 qindëshe, 5 dhjetëshe dhe 8 njëshe _____
b) 9 qindëshe, 1 dhjetëshe dhe 0 njëshe _____
c) 9 njëshe, 4 qindëshe dhe 6 dhjetëshe _____
ç) 0 dhjetëshe, 0 njëshe dhe 8 qindëshe _____

7 **Zbulo numrin!**

327	185	492	602
256	42	813	523

Unë jam numër treshifror.
Shifra ime në vendin e qindësheve nuk është 2.
Shifra ime në vendin e dhjetësheve është 2.
Shifra ime e njësheve rrethohet në dhjetëshen më të madhe.

Përgjigje: _____

8 **Sipas ngjyrës së lapsave ngjyrosi numrat te tabela.**

163	774	337	204	832	698	157	392	962
963	884	458	254	589	640	753	414	810
628	305	672	166	329	194	234	762	124
803	950	504	875	457	574	114	313	677
371	155	262	104	613	382	845	553	204
156	820	556	287	124	594	690	891	162
184	150	199	299	399	204	165	258	306
460	489	287	578	259	469	795	358	128
253	756	600	151	610	265	822	821	444

3 QINDËSHE
6 DHJETËSHE
8 QINDËSHE
4 NJËSHE
6 QINDËSHE
5 DHJETËSHE

ZBËRTHIMI I NUMRIT TRESHIFROR NË QINDËSHE, DHJETËSHE DHE NJËSHE

Të përkujtohemi!

Çdo numër mund të shkruhet në formën e zbërthyer, duke shfrytëzuar vlerën vendore të çdo shifre te numri.



35 = 30 + 5 = 3DH + 5NJ



135 = 100 + 30 + 5 = 1Q + 3DH + 5NJ

Te cili numër shifra 3 ka vlerë vendore më të madhe?
Shifra 3 te të dy numrat ka vlerë të njëjtë, pasi edhe te numri 35 edhe te 135 është në vendin e dhjetësheve. Vlera e tij është 30.

1 **Lexoji numrat prej figurave, shkruaji te tabela në Q, DH dhe NJ dhe zbërtheji.**



Q	DH	NJ

_____ + _____ + _____ = _____



Q	DH	NJ

_____ + _____ + _____ = _____



Q	DH	NJ

_____ + _____ + _____ = _____



Q	DH	NJ

2 **Zbërtheji numrat si te shembulli.**

869 = 8Q+6DH+9NJ

320 =

536 =

607 =

900 =

481 =

559 =

274 =

170 =

856 =

759 =

700 =

481 =

357 =

987 =

3 **Zbërtheji numrat si te shembulli.**

a) 423 = 400 + 20 + 3

568 = _____ + _____ + _____

379 = _____ + _____ + _____

495 = _____ + _____ + _____

374 = _____ + _____ + _____

592 = _____ + _____ + _____

671 = _____ + _____ + _____

b)



4 **Lidhi numrat me zbërthimin përkatës.**

400 + 50 + 3	847
600 + 80 + 1	795
800 + 40 + 7	376
200 + 60 + 4	453
500 + 10 + 2	129
700 + 90 + 5	512
100 + 20 + 9	681
300 + 70 + 6	938
900 + 30 + 8	264

5 **Lidhi numrat me zbërthimin përkatës.**



6 **Shkruaji në formën e zbërthyer:**

a) paraardhësin e numrit 660, _____

b) pasardhësin e numrit 338, _____

c) numrin tek më të madh treshifror, _____

ç) numrin çift më të vogël treshifror. _____

RRUMBULLAKIMI
NUMRAT DYSHIFRORË DERI TE DHJETËSHJA MË E AFËRT, NUMRAT TRESHIFRORË DERI TE DHJETËSHJA DHE QINDËSHJA MË E AFËRT

Të përkujtohemi!

Numrat 24 dhe 27 t'i zbërthejmë deri te dhjetëshja më e afërt.

Rrumbullakojmë te dhjetëshja paraprake ← | → Rrumbullakojmë te dhjetëshja vijuese

20	21	22	23	24	25	26	27	28	29	30

Dhjetëshja deri tek e cila është më afër numrit 24 është 20. Themi numri 24 është rrumbullakuar 20 si dhjetëshja më e afërt.

Numri 27 është më afër deri te dhjetëshja e tretë, pra themi se numri 27 është rrumbullakuar në 30 si dhjetëshja më e afërt.

Mbaj mend!
Nëse shifra e njësheve është 4 ose më e vogël se 4 (3, 2, 1), atëherë numrin e rrumbullakojmë në dhjetëshen paraprake.

Nëse shifra e njësheve është 5 ose më e madhe se 5 (6, 7, 8, 9), atëherë rrumbullakojmë në dhjetëshen e ardhshme.

Numrat 430 dhe 470 t'i rrumbullakojmë te qindëshja më e afërt.

Rrumbullakojmë në dhjetëshen vijuese ← | → Rrumbullakojmë në qindëshen paraprake

0	10	20	30	40	50	60	70	80	90	100
100	110	120	130	140	150	160	170	180	190	200
200	210	220	230	240	250	260	270	280	290	300
300	310	320	330	340	350	360	370	380	390	400
400	410	420	430	440	450	460	470	480	490	500
500	510	520	530	540	550	560	570	580	590	600
600	610	620	630	640	650	660	670	680	690	700
700	710	720	730	740	750	760	770	780	790	800
800	810	820	830	840	850	860	870	880	890	900
900	910	920	930	940	950	960	970	980	990	1 000

Rrumbullakojmë në dhjetëshen vijuese | Rrumbullakojmë në qindëshen paraprake

Mbaj mend!
Nëse shifra e dhjetësheve është 4 ose më e vogël se 4 (3, 2, 1), atëherë numrin e rrumbullakojmë në qindëshen paraprake.

Nëse shifra e dhjetësheve është 5 ose më e madhe se 5 (6, 7, 8, 9), atëherë numrin e rrumbullakojmë në qindëshen vijuese.

1 **Ngjyrose bananen tek e cila është shkruar dhjetëshja më e afërt tek e cila do ta rrumbullakojmë numrin.**



2 **Numrat e dhënë rrumbullakoji deri te dhjetëshja më e afërt.**



3 **Lidhi bletët sipas numrit të tyre me bletarinë me qindëshen më të afërt.**





4 **Rrumbullakoji numrat e qindëshes më të afërt dhe ngjyrosi balonat sipas kërkesave.**



5 **Plotësoji fjalitë dhe rrumbullako numrat deri te qindëshja më e afërt.**

Shembull: Numri 368 është ndërmjet 300 dhe 400 dhe rrumbullakohet në _____.

a) Numri 720 është ndërmjet _____ dhe _____ dhe rrumbullakohet në _____.

b) Numri 645 është ndërmjet _____ dhe _____ dhe rrumbullakohet në _____.

c) Numri 599 është ndërmjet _____ dhe _____ dhe rrumbullakohet në _____.

ç) Numri 202 është ndërmjet _____ dhe _____ dhe rrumbullakohet në _____.

KRAHASIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË, DUKE SHFRYTËZUAR SHENJAT “>“, “=“ DHE “<“

Të përkujtohemi!

Cila prej shenjave: >, < ose = duhet të qëndrojë te rrethi që gjykimi të jetë i saktë?

36 ◯ 46 74 ◯ 79

18 ◯ 26 81 ◯ 81

92 ◯ 29

Gjatë krahasimit të numrave dyshifrorë numri i dhjetësheve është i njëjtë, atëherë krahasohen njëshet!

Q	DH	NJ
1	2	3



Q	DH	NJ
1	2	7

Numri 123 ka një qindëshe, aq sa edhe numri 127. Edhe të dy numrat kanë shifra dy në vendin e dhjetësheve, kurse shifra e njësheve te 123 është më e vogël se shifra e njësheve te 127.
Përfundojmë: 123<127
Lexohet: 123 (njëqind e njëzet e tre) është më e vogël se 127 (njëqind e njëzet e shtatë).

Q	DH	NJ
5	4	7



Q	DH	NJ
3	3	7

5 qindëshe është më shumë se 3 qindëshe pasi që 5>3.
Përfundojmë se 547 > 337
Lexohet: 547 (pesëqind e dyzet e shtatë) është më e madhe se 337 (treqind e tridhjetë e shtatë).

Mbaj mend!
Kur krahasohen numrat treshifrorë fillohet me krahasim të shifrave të qindësheve, nëse janë të njëjta krahasohen shifrat e dhjetësheve, nëse edhe ato janë të njëjta atëherë krahasohen shifrat e njësheve.

Nëse shifrat e qindësheve janë të ndryshme, numrat treshifrorë menjëherë mund të krahasohen.

1 **Paraqiti numrat te drejtëza numerike dhe krahasoji!**

495 [<] 519



769 [ ] 764



238 [ ] 253



1

1 **Shkruaje njërin prej shenjave >, < ose = për t'i krahasuar numrat treshifrorë.**

Q	DH	NJ
8	4	7
6	9	1
5	4	8
2	0	9

Q	DH	NJ
8	4	8
1	9	3
5	4	8
2	9	0



2 **Krahasoji këta numra, duke i shfrytëzuar shenjat >, < ose =.**

3Q 8DH 2NJ ◯ 4Q 8DH 5NJ 7Q 7DH 6NJ ◯ 7Q 6DH 6NJ 5Q 1DH 3NJ ◯ 5Q 1DH 4NJ

345 ◯ 261 ◯ 123 ◯ 123 ◯ 720 ◯ 745 ◯ 551 ◯ 155 ◯ 159

3 **Shkruaj shifër te rrethi që krahasimi të jetë i saktë:**

123 < ◯21 4◯3 > 437 506 < 50◯ ◯44 > 834

63◯ = 6◯9 ◯000 > 999 735 > ◯35

4 **Prej shifrave 8, 5 dhe 3 formo: numër treshifror më të madh i cili në vend të njësheve do ta ketë shifrën 5 dhe numrin treshifror më të vogël.**

Numri më i madh: _____

Numri më i vogël: _____

Krahasoji: _____ ◯ _____

5 **Bojana ka menduar dy numra treshifrorë. Njëri numër ka 4 qindëshe, 3 dhjetëshe dhe 8 njëshe, kurse numri tjetër gjendet ndërmjet numrave 354 dhe 356. Cilët numra i ka menduar Bojana? Krahasoji!**

Krahaso: _____ ◯ _____

Përgjigje:

6 **Krahasoji:**

Numri më i vogël prej qindëshes së dytë dhe numri tek më i vogël prej qindëshes së dytë.

_____ ◯ _____

Numri i tretë prej qindëshes së tretë dhe numri i katërt prej qindëshes së katërt.

_____ ◯ _____

RENDITJA E NUMRAVE DYSHIFRORË DHE TRESHIFRORË DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Cilët numra dyshifrorë janë paraqitur te figurat? Shkruaji, krahasoji, kurse pastaj renditi, duke filluar prej më të madhit!



Me siguri vërejte se krahasimi të ndihmon t'i rendisësh numrat prej më të madhit deri te më i vogli.

Mbaj mend!

Duke e shfrytëzuar krahasimin, numrat treshifrorë, ato mund të renditen prej më të voglit kah më i madhi dhe anasjelltas. Eja t'i emërtojmë numrat treshifrorë dhe t'i rendisim!

200 120 600 400

600 > 400 > 200 > 120



1 **Shkruaji me shifra këta numra, kurse pastaj renditi, duke filluar prej më të madhit. Përdore shenjën për krahasim!**

a) katërqind e tridhjetë e pesë

b) katërqind e pesëdhjetë e tre

c) dyqind e njëzet e nëntë

ç) dyqind e shtatë

2 **Renditi numrat, duke filluar prej më të voglit!**



3 **Lidhi numrat e barabartë, kurse pastaj renditi, duke filluar prej më të voglit!**

6Q 7DH 4NJ	7Q	2DH 9NJ	2Q 9NJ	2Q 9DH	6Q 4DH 7NJ
290	29	674	700	647	209



4 **Me shifrat 7, 5 dhe 4 shkruaji të gjithë numrat treshifrorë:**

a) çift; b) tek.

_____ _____

Shifrat të mos përsëriten.

Renditi sipas madhësisë prej më të voglit nga më i madhi!

_____

5 **Shkruaji paraardhësin dhe pasardhësin e numrit, sill përfundim për këto pyetje:**

Paraardhësi dhe pasardhësi i numrit çift është numri _____ .

Paraardhësi dhe pasardhësi i numrit tek është numri _____ .

paraardhës	numër	pasardhës
	276	
	351	
	920	
	583	

6 **Te rrota e fatit pas gjashtë rrotullimeve janë fituar numrat: 701, 240, 137, 559, 348 dhe 722. Shkruaji pasardhësi te tyre te rrota e zbrazët dhe renditi sipas madhësisë prej më të voglit deri te më i madhi dhe prej më të madhit deri te më i vogli!**

Prej më të madhit deri te më i vogli:

_____

Prej më të voglit deri te më i madhi:

_____



numër

pasardhës

7 **Shkruaji të gjithë numrat treshifrorë të cilët mund të vendosen në vendin X, që të jetë saktë:**

a) 428 < X < 435

b) 703 > X > 697

VLERËSIMI I VENDIT TË NUMRIT NDËRMJET QINDËSHEVE TE DREJTËZA NUMERIKE

Të përkujtohemi!

Cakto numrat të cilët duhet të jenë të shkruar te vendet e shënuara.



1 **Te vendet e zbrazëta shkruaji cilët numra duhet të qëndrojë në te drejtëza numerike.**





2 **Gjeji numrat e fshehur nën tërfil.**

P= R= A =

M = C= K=

Mbaj mend!

Për të caktuar ku qëndron një numër treshifror te drejtëza numerike, së pari caktojmë ndërmjet cilave qindëshe gjendet!

Për shembull: 340 – numri gjendet ndërmjet 300 dhe 400.

Pasi drejtëza e dhënë është me dhjetë ndarje, hapi i ndarjeve shënohet 10 njësi, pra lehtë do të caktojmë ku duhet të qëndrojë numri përkatës.



3 **Gjeji vendet e numrave te drejtëzat e dhëna.**

460

650

830

390

4 **Plotësoji qindëshet e plota ndërmjet të cilave gjenden numrat e dhënë treshifrorë, kurse pastaj paraqiti te drejtëza numerike.**

a) 430 është ndërmjet 400 dhe ( ) b) 650 është ndërmjet ( ) dhe ( )

c) 770 është ndërmjet ( ) dhe 800 ç) 510 është ndërmjet ( ) dhe ( )



5 **Paraqiti te drejtëzat numerike edhe numrat e tjerë, sipas shembullit.**

546

978

423

221

386

455

6 **Anija e paramenduar lundron nëpër mbretërinë e numrave treshifrorë gjatë një javë dhe ndalet te ndonjë numër i caktuar treshifror. Ditën e hënë ai është te numri 404, kurse pastaj është ndalur te numri më i vogël vijues që është më i madh se numri paraprak. Janë dhënë vendqëndrime tek anija, cakto cilën ditë te cili numër treshifror gjendet!**
Plotësoje tabelën!
Ngjyrosi pozicionet te të cilat qëndron anija, pasi që do ta plotësosh tabelën e zbrazët!

dita	numri
e hënë	404
e martë	
e mërkurë	
e enjte	
e premte	
e shtunë	
e diel	

+	1	2	3	4	5	6	7	8	9
400	401	402	403	404					
410									
420									
430									
440									
450									
460									
470									

TË SHPREHURIT DHE TË SHKRUARIT E NUMRAVE RRESHTORË MË SË PAKU TE NUMRI I NJIQIND

Të përkujtohemi!

Shqyrto figurën dhe përgjigju:
Cili automobil ka arritur i fundit te caku?
Cilin vend e ka zënë automobili i fundit?

Mbaj mend!

Numrat e automobilave e paraqesin renditjen sipas të cilës ato kanë arritur deri te caku.
Ata janë **numra rreshtorë**.
Numrat rreshtorë shkruhen ashtu që pas numrit shkruhet pikë.

10. i dhjeti **75. I shtatëdhjetë i pesti**

1 **Shqyrto figurën dhe zbulo! Cili me radhë është planeti Toka, kurse cili planetë është i pari dhe më afër deri te Dielli? Sa planetë ka Sistemi Diellor? Cili planet me radhë është planeti më i madh?**



2 **Ana ka vendosur ta mbushë shportën me ushqim. Kërkon prej teje t'i ndihmosh, t'i mbledhë dredhëzat dhe mollët. Në cilat fusha duhet të ndalet që t'i marrë? Numëroji fushat e shtegut, duke filluar prej fushës së parë.**



Dredhëzat gjenden te fushat me numër rendor:

_____

Mollët gjenden te fushat me numër rendor:

_____

Prej cilës pemë Ana ka mbledhur më së shumti?

_____

3 **Shkruaji numrat rendorë me fjalë:**

76. _____

45. _____

_____ 24. _____

_____ 81.
92. _____


52. _____

4 **Shkruaje numrin rendor të:**

a) dita e sotshme në muajin _____

b) muaji në vitin kur ti e feston datëlindjen tënde. _____

5 **Lokomotiva tërheq vagonë, kurse çdo vagon ka numër të ndryshëm rendor. Shkruaji numrat rendorë sipas kërkesave:**

- vagonin e tretë shënoje me numrin rendor tridhjetë e gjashtë,
- vagoni i cili gjendet ndërmjet 47. dhe 55. është pesëdhjetë e një,
- vagonin para 98. shënoje me numrin rendor tek i cili të dy shifrat janë të njëjta,
- vagonin e fundit shënoje me numrin rendor i njëqindi.

NJOHJA DHE EMËRTIMI I NUMRAVE ÇIFT DHE TEK DERI 1 000

1 Çdo numër çift ngjyrose me ngjyrë të gjelbër, kurse numrat tek me ngjyrë të kuqe.

32	45	74	71	60
55	23	94	88	11
56	49	27	73	35

Mbaj mend!

Çdo **numër çift** mbaron me shifrën
0, 2, 4, 6 ose 8.
Çdo **numër tek** mbaron me shifrën
1, 3, 5, 7 ose 9.

2 Lidh që të jetë saktë!



3 a) Shkruaji numrat çift të cilët gjenden ndërmjet numrave 602 dhe 620.



b) Shkruaji numrat tek të cilët janë më të mëdhenj se 263, kurse më të vegjël se 281.



4 **Shkruaji paraardhësit dhe pasardhësi te nunrave dhe sill përfundim se numra e shkruar a janë çift ose tek!**





paraardhës pasardhës paraardhës pasardhës paraardhës pasardhës paraardhës pasardhës

Paraardhësi dhe pasardhësi i numrit çift është numri _____.

Paraardhësi dhe pasardhësi i numrit tek është numri _____.

5 **Paraardhësi dhe pasardhësi i numrit tek është numri:**

a) të gjithë numrat tek prej më të voglit deri te më i madhi

b) të gjithë numrat çift prej më të madhit deri te më i vogli.



6 **Stefani ka menduar numër çift treshifror. Numri ka 9 qindëshe dhe 3 dhjetëshe. Cilin numër e ka menduar Stefani? A ka edhe numra të tjerë të cilët ndoshta Stefani i ka menduar, por përmbajnë numër të njëjtë të qindësheve dhe dhjetësheve?**

Përgjigje: _____

7 **Ndihmoji bletës Maja të arrijë deri te lulet duke filluar prej numrit 15, duke fluturuar te numrat tek të arrijë deri te numri 89.**

		15	8	16	50	44
22	34	37	92	54	66	38
48	2	49	56	36	70	86
14	94	73	61	4	58	24
30	28	12	57	76	98	52
68	42	96	3	19	33	65
10	74	82	40	64	88	7
62	20	18	78	90	26	21
80	32	46	60	72	6	93
						89

FORMIMI I VARGUT PREJ NUMRAVE PËR DY MË TË MËDHENJ OSE PËR DY MË TË VEGJËL PREJ NUMRIT TË DHËNË DERI 1 000

1 **Lina dhe Jasini kërcejnë me thasë. Lina ka kërcyer sipas rregullës prapa për 2, kurse Jasini ka kërcyer përpara për 2. Shkruaji te cilët numra do të kërcejë Lina, kurse të cilët Jasini?**



Mbaj mend!

Gjatë bërjes së vargjeve numerike përcillet rregulla e numërimit. Nëse e zbulon atë rregull, mund të gjesh shumë anëtarë të vargut numerik. Për shembull:
Përpara "+2": 0, 2, 4, 6, 8, 10, 12, 14...
Prapa "-2": 20, 18, 16, 14, 12, 10...
Cili është anëtari i dhjetë te vargu i parë?
Kurse cili është anëtari i tetë te vargu i dytë?

2 **Davori ka shkuar në kinema. Shkruaji numrat të cilët duhet t'i kalojë te shtegu prej shtëpisë së tij deri në kinema, duke shfrytëzuar hap përpara për 2.**



Cili numër do të jetë i fundit kur Davori do të arrijë në kinema?

Përgjigje: Numri i fundit tek i cili Davori do të ndalet para hyrjes në kinema është numri _____

3 **Formo varg sipas rregullës "prapa për 2".**

– 2

265 263 ☐ ☐ ☐

249 247 ☐ ☐ ☐

– 2

325 323 ☐ ☐ ☐

290 288 ☐ ☐ ☐

4 **Zbulo rregullën dhe vazhdoji vargjet.**

450 ☐ 454 456 ☐ ☐ 462 ☐ ☐ ☐

Rregulla është _____

630 628 ☐ 624 ☐ ☐ 618 ☐ ☐ ☐

Rregulla është _____

280 ☐ 276 274 ☐ ☐ 268 ☐ ☐ ☐

Rregulla është _____

566 568 ☐ 572 ☐ ☐ 578 ☐ ☐ ☐

Rregulla është _____

5 **Mina sot ka 856 denarë, ajo çdo ditë ka kursyer nga 2 denarë për të blerë syza, kapelë dhe kostume të preferuara. Sa denarë do të ketë Mina pas një jave dhe a do të ketë mjaft të blejë të gjitha punët e dëshiruara ose vetëm disa? Çka me siguri mund të blejë Mina?**

856 denarë

440 denarë

430 denarë

870 denarë

Përgjigje:

☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

1 Prej kartelave të dhëna me shifra formo numra treshifrorë, shkruaji me shifra dhe me fjalë. Lexoja shokut tënd cilët numra i ka formuar!



numër ☐ _____

numër ☐ _____

numër ☐ _____

2 Shkruaji numrat nga abakusi.



3 Plotëso që të jetë saktë!

342 = ☐ Q + ☐ DH + ☐ NJ

719 = ☐ Q + ☐ DH + ☐ NJ

☐ = 1Q + 7DH + 6NJ

☐ = 5Q + 3DH + 4NJ

4 Te drejtëzat numerike te të cilat janë shënuar dy qindëshe të plota fqinje, plotësoji numrat treshifrorë të cilët mungojnë!



5 Ngjyrose rrethin tek i cili është shkruar shenja e saktë.

245	>	=	<	254	562	>	=	<	561
393	>	=	<	339	162	>	=	<	261

6 Shkruaji katër numra tek. Shkruaji pasardhësin dhe paraardhësin e çdo numri të numrave. A janë ata numra çift ose tek.



GJEOMETRIA

Rezultatet nga të mësuarit:

- mat dhe vizaton segment;
- përshkruan forma 2D dhe 3D dhe përmend ngjashmëritë dhe ndryshimet ndërmjet tyre;
- numëron dhe vizaton vija të simetrisë;
- cakton pozitën e objektit te rrjeta katrore dhe lëviz objekte sipas rrjetës katrore.

Përmbajtjet:

- Segment
- Forma 2D
- Forma 3D
- Vija e simetrisë dhe simetria te rrethina
- Pozita, kahja dhe lëvizja

Fjalori i koncepteve të reja

- segment
- pikë
- i takon
- nuk i takon
- kulm
- brinjë
- këndii drejtë
- shtatëkëndësh
- tetëkëndësh
- nëntëkëndësh
- dhjetëkëndësh
- faqe
- teh
- prizëm
- simetri
- vijë e simetrisë
- rreshta
- kolona
- rrjeta katrore

SEGMENTI

Të përkujtohemi!

Vija e gjatë e drejtë quhet **DREJTËZ**.



Te vija e drejtë mund të **shtrihet** (i takon) dhe të **mos të shtrihet** (nuk i takon) ndonjë pike.

Pjesë e drejtëz që është kufizuar me dy pika quhet SEGMENT.

Pikat A dhe B janë pikat e skajshme të segmentit. Gjatësinë e çdo segmenti e shënojmë $\overline{AB}$.

Mate segmentin $\overline{AB}$ dhe kontrollo se gjatësia e tij a është 7cm.

1 **Shkruaji në mënyrë tabelare numrin e vijave dhe pikave:**



DREJTËZAT	PIKAT	SEGMENTET	VIJAT E LAKUARA TË HAPURA	VIJAT E LAKUARA TË MBYLLURA

2 Lidhi pikat sipas shembujve të dhënë, duke shfrytëzuar vizoren.



3 Emërtoji dhe shkruaji të gjitha segmentet e vizatimit. Sa segmente ka gjithsej?



Përgjigje: _____

4 Te segmenti AB shtrihen pikat _____, kurse pikat _____ nuk shtrihen.



Shënimi i pikave:
- shtrihet/i takon segmentit
- nuk shtrihet/nuk i takon segmentit
shtrihet/i takon

5 Vizato segment tek i cili i takojnë pikat A dhe B dhe pika R e cila nuk i takon segmentit.

6 **Duke shfrytëzuar vizoren, mati gjatësitë e segmenteve dhe shkruaj.**



$\overline{AB}$ = ☐ $\overline{MN}$ = ☐ $\overline{OP}$ = ☐ $\overline{ST}$ = ☐

7 **Duke shfrytëzuar vizoren, vizato tre segmente me gjatësi dhe emërtoi:**

a) 5 cm

b) 3 cm

c) 8 cm

8 **Sa segmente ka në vizatim:**



Në vizatim ka ☐ segmente.

Segmenti më i gjatë është ☐ ; ai është i gjatë ☐ cm.

Segmenti më i shkurtër është ☐ ; gjatësia e tij është ☐ cm.

FORMAT 2D

NJOHJA DHE EMËRTIMI I FORMAVE 2D

Të përkujtohemi!

Segmente të lidhura ku pika fillestare prej segmentit të parë dhe pika e skajshme e segmentit të fundit puthiten dhe formojnë **SHUMËKËNDËSH**.

SHUMËKËNDËDH është forma 2D e mbyllur prej segmenteve të lidhura. Çdonjërin prej segmenteve e quajmë brinja e shumëkëndëshit.

Çdo shumëkëndësh ka tre ose më shumë kënde.
Shumëkëndëshat i emërtojmë sipas numrit të këndeve: trekëndësh, katërkëndësh, pesëkëndësh, gjashtëkëndësh, shtatëkëndësh, tetëkëndësh, nëntëkëndësh, dhjetëkëndësh.

trekëndësh

katërkëndësh

pesëkëndësh

gjashtëkëndësh

shtatëkëndësh

tetëkëndësh


nëntëkëndësh

dhjetëkëndësh

1 **Emërtoji format 2D të paraqitura te vizatimi dhe shkruaji emrat e tyre.**



2 Numëro dhe plotëso tabelën sipas kërkesave:



SHËNIMI DHE EMËRTIMI I KULMIT DHE BRINJËS SË FORMAVE 2D

Të përkujtohemi!

Elementet e shumëkëndëshit janë:



brinjë kulme këndë

1 Shkruaji dhe emërtoji shumëkëndëshat e dhënë sipas brinjëve, kulmeve dhe këndeve.

Forma 2D	emri i shumëkëndëshit	brinjët	kulmet	këndet

2 Sa brinjë dhe sa këndë ka çdonjëri prej shumëkëndëshave?



brinjë ☐ brinjë ☐ brinjë ☐ brinjë ☐

këndë ☐ këndë ☐ këndë ☐ këndë ☐



brinjë ☐ brinjë ☐ brinjë ☐ brinjë ☐

këndë ☐ këndë ☐ këndë ☐ këndë ☐

3 Lidhi shumëkëndëshat sipas numrit të brinjëve dhe kulmeve të cilët i kanë:



4 Numëroji format e kërkuara te çdo figurë. Përgjigja e saktë të zbulon shkronjën.



Sa trekëndësha ka në vizatim?			Sa katrorë ka në vizatim?			Sa gjashtëkëndësha ka në vizatim?			Sa drejtkëndësha ka në vizatim?		
18	7	14	9	11	8	5	7	8	8	9	6
M	K	O	E	B	Ë	C	P	N	D	R	T

Cilën fjalë e fitove: _____

5 Sfida! A mund të zbulosh cilat prej formave 2D i ndërtojnë shumëkëndëshat? Lidhe çdo shumëkëndësh me pjesët e tij përbërëse si te shembulli. Pastaj preje prej letrës dhe kontrollo përgjigjet që i zgjodhe!



NJOHJA E KËNDIT TË DREJTË TE FORMAT 2D

Preni rreth prej letre. Mbështilleni rrethin përgjysmë. Pastaj mbështilleni edhe njëherë përgjysmë. Fitoni 4 forma barabarta 2D të, si te figura.
Është formuar këndi i drejtë!



Edhe këndi te vizorja trekëndore te figura është kënd i drejtë





1 **Sa është ora në orën e murit?**
Çfarë këndi formojnë akrepat e orës?

Ora e murit tregon orën _____.

Akrepat formojnë _____.

2 **Gjeji këndet e drejta te këto figura të bëra prej formave 2D.**



Te figura ka _____ kënde të drejta.



Te figura ka _____ kënde të drejta.

3 Vëre çfarë këndi formon shtrati për ndeje?

Përgjigje: _____

4 Kudo mund të vërejmë kënde të drejta në rrethinën tonë?



5 Sa kënde të drejta vëren në vizatim?



Vërehen _____ kënde të drejta.

FORMAT 2D SIPAS NUMRIT TË BRINJËVE

1 **Lidhi pikat duke lëvizur në kahjen e akrepave të orës.**



Cilën figure e fitove?

Përgjigje: _____

Sa brinjë ka figura e fituar? ☐

Sa kulme ka figura e fituar? ☐

Sa këndë ka figura e fituar? ☐

2 **Sa brinjë ka çdo nëntëkëndësh?**

Përgjigje: _____

3 **Sa kulme ka shtatëkëndëshi?**

Përgjigje: _____

4 **Vizato trekëndëshat te gjashtëkëndëshi i dhënë.**



FORMAT 3D
NJOHJA DHE EMËRTIMI TE FORMAT 3D

Përsërisim dhe përkujtohemi!

1 Lidhi format 3D me emrin përkatës:











- KONI
- CILINDRI
- KUBI
- TOPI
- PIRAMIDA
- KUADRI

2 **Prej cilave forma 2D përbëhen këto forma 3D?**



Kubi përbëhet prej: _____



Piramida në vizatim përbëhet prej: _____



Te cilindri vërehen _____ rrathë.



Kuadri përbëhet prej: _____



3 **Cilat prej formave 3D i njeh te figurat e dhëna?**

_____	_____	_____	_____	_____	_____
					
_____	_____	_____	_____	_____	_____
					
_____	_____	_____	_____	_____	_____

ELEMENTET E FORMAVE 3D

ELEMENTET E PRIZMIT – KULMI, TEHU DHE FAQJA





Tehu: segmenti i përbashkët i dy faqeve fqinje.

Kulmi: pika ku bashkohen tehet.

Faqja: Sipërfaqja e rrafshët me të cilën është kufizuar forma 3D.

Sa faqe ka kubi?

Kubi ka _____ faqe.



Çfarë forme kanë faqet e kubit?

Faqet e kubit janë _____.

Prej cilës rrjetë mund të bëhet kubi?





1 Duke shfrytëzuar skemën, vizato format e njëjta të bëra prej kubeve.



2 Duke shfrytëzuar skemën, ngjyros format e njëjta të bëra prej kubeve.





Sa faqe ka kuadri?

Kuadri ka _____ faqe.

Çfarë forme kanë faqet e kuadrit?

Faqet e kuadri janë

_____.



3 **Duke shfrytëzuar skemën, vizato format e njëjta të bëra prej kuadrove. Kubi a është kuadër?**







CAKTIMI I FAQEVE, TEHEVE DHE KULMEVE TE FORMAT 3D

1 Vështroji format 3D, vëreji ngjashmëritë dhe plotësoje tabelën.

Forma 3D	Numri i kulmeve	Numri i teheve	Numri i faqeve
			
			
			

2 Vizato rrjetën e:

kubit

kuadrit

3 Sfida! Figura e dhënë është bërë prej kubeve në ngjyra të ndryshme. Nëse e vërejmë prej lart, çka do të vërejmë? Lidhe formën që e vëreni me vizatimin përkatës.
Bëni edhe ju forma 3D prej kubeve. Shikoni prej më shumë anëve (prej lart, prej përpara, prej majtas...). Vizatoni dhe ngjyrosni çka vëreni!



LIDHJA E FORMAVE 2D ME RRJETA TË FORMAVE 3D

1 Prej cilave forma 2D përbëhet çdo rrjetë e forms 3D?



Rrjeta e **piramidës trekëndore**.

Përbëhet prej **katër trekëndëshave**.



Rrjeta e _____

Përbëhet prej _____.



Rrjeta e _____

Përbëhet prej _____.



Rrjeta e _____

Përbëhet prej _____.

VIJA E SIMETRISË DHE SIMETRIA NË RRETHINË

NJOHJA DHE VIZATIMI I VIJAVE TË SIMETRISË TE FORMAT 2D

Të përkujtohemi!

Kur një formë është simetrike? Si duket ajo? Çka është karakteristike për formën që është simetrike? Përpiquni të vizatoni dhe të preni formë simetrike, nëse e mbështillni letrën përgjysmë!

Në rrethinën tonë, por edhe në natyrë, hasim shumë forma dhe sende simetrike. A e vëreni simetrinë e tyre?

1 Tërhiqi vijat e simetrisë të këtyre formave 2D:



2 **Disa shkronja prej alfabetit tone janë simetrike. Gjeni vijat e mundshme të simetrisë të shkronjave dhe vizatoni!**

A M H X O

Çka vëreni?
Te disa shkronja mund të tërhiqen një vijë të simetrisë.
Te disa shkronja mund të tërhiqen dy vija të simetrisë.

3 **Gjeje pjesën tjetër prej shtëpive të cilat janë simetrike dhe lidhi ndërmjet veti.**



4 Vizatoji pjesët simetrike të figurave. Gjatë të vizatuarit shfrytëzo rrjetin prej katrorëve.



5 Çdo formë 2D vizatoje ashtu që do të fitosh formë 2D simetrike.



POZITA, KAHJA DHE LËVIZJA

CAKTIMI I POZITËS TE RRJETA KATRORE

1 Te rrjeta e dhënë gjeje pozitën e çdo rrethi të ngjyrosur në ngjyrën përkatëse dhe barte figurën në tjetër rrjetë koordinative!





2 Në cilën pozitë te rrjeta katrore gjenden kafshët. Shkruaje së pari pozitën në kolonë, kurse pastaj te rreshti!

	1	2	3	4	5	6	7	8	9
1									
2									
3									
4									
5									
6									
7									
8									
9									

	2	9			

3 Gjeje pozitën e çdo kafshe te rrjeta dhe shkruaje, ashtu që së pari do ta caktosh pozitën e rreshtit, kurse pastaj te kolona tek e cila gjendet.

	A	B	C	Ç	D	E	Ë	I	J	K	L	M
1												
2												
3												
4												
5												
6												
7												
8												
9												
10												
11												
12												

	1	Ë			

4 **Ngjyrose rrjetën sipas instruksioneve të dhëna!**

	A	B	C	Ç	D	E	Ë
1							
2							
3							
4							
5							
6							
7							

A-1 Ë-1 A-7 Ë-7	B-2 B-6 E-6 E-2	C-3 D-3 C-5 D-5
Ç-7 Ë-4 Ç-1 A-4	Ç-4	C-4 Ç-5 D-4 Ç-3

5 **Duke i shfrytëzuar shigjetat, tregoja rrugën majmunit të arrijë deri te banania, kurse valixhen vendose në aeroplan. Gjeji disa rrugë të ndryshme të lëvizjes nëpër rrjetë!**







6 Vëreje mapën dhe cakto pozicionet e objekteve.





7 Për Ivanin që të gjendet më së miri, mapën e qytetit e ka vendosur te rrjeta katrore. Ndihmoji Ivanit që ta shkruajë pozitën e çdo objekti në qytet në pajtim me mapën.





LËVIZJA E OBJEKTEVE NË KAHJEN E DHËNË TE RRJETA KATRORE

Për ta caktuar pozitën e objekteve do ta shfrytëzosh **rrjetën katrore**, tek e cila janë emërtuar kolonat (A, B, C,...E) dhe rreshtat (1, 2, 3,...6).

1 **Shkruaj cili send gjendet te pozita e dhënë prej rrjetës koordinative:**



A, 3 → _____ Ç, 6 → _____

B, 5 → _____ D, 4 → _____

C, 1 → _____ E, 2 → _____

2 Vizatoji shigjetat sipas të cilave duhet të lëvizë polici për të arritur deri te automobili i tij:



1 Vizato segment AB me gjatësi prej 6cm. Shëno pikë C e cila i takon segmentit dhe pikë D e cila nuk i takon segmentit AB.

2 Çdo formë 3D lidhe me formën 2D prej të cilës është formuar.



3 Nga sa vija të simetrisë mund të tërhiqen te këto figura:



a) _____ b) _____ c) _____ ç) _____

4 Paraqite pozitën e çdo kafshe te rrjeta ei dhënë katore.



KAFSHA	POZITA	KAFSHA	POZITA
KALI	D - 6		

OPERACIONET ME NUMRA

Rezultatet nga të mësuarit. Nxënësi:

- mbledh dhe zbret numra deri 1 000
- dyfishon dhe përgjysmon numra deri 1 000
- shumëzon dhe pjesëton me 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10
- gjen gjysmën, të tretën, të katërtën, të pestën, të gjashtën, të tetën, të nëntën dhe të dhjetën prej grupit të sendeve deri 100

Përmbajtjet:

- Mbledhja dhe zbritja deri 1 000
- Dyfishimi dhe përgjysmimi i numrave deri 1 000
- Shumëzimi dhe pjesëtimi me 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 dhe 10
- Thyesat

Fjalori i koncepteve të reja

- numër
- mbledhës
- shumë
- i zbritshëm
- zbritës
- ndryshimi
- veti komutative
- dyfishim
- përgjysmim
- shumëzim
- shumëzues
- prodhim
- pjesëtim
- i pjesëtueshëm
- pjesëtues
- herës
- mbetje
- thyesë
- numërues
- emërues
- vijë thyesore

MBLEDHJA E QINDËSHEVE DERI 1 000

Në klasën e dytë i shfrytëzoje shtyllat numerike gjatë mbledhjes.

Të përkujtohemi!

Përkujtohu në mënyrën e mbledhjes së dhjetësheve të plota.



4 DH + 1 DH = 5 DH

	DH	NJ
	4	0
+	1	0

40 + 10 = ☐

mbledhje

40 + 10 = 50

mbledhës mbledhës shuma



5 DH + 5 DH = 10 DH = 1 Q

	Q	DH	NJ
		5	0
+		5	0

50 + 50 = ☐

10 DH mund t'i paraqesim si 1 Q = 100



Mbaj mend!
Gjatë mbledhjes së numrave dyshifrorë me dhjetëshe të plota, mblidhen shifrat e dhjetësheve, kurse në vendin e njësheve shkruhet zero.

1 **Njehso:**

a) 40 + 30 = ___ + 40 = 70

b) 60 + 20 = 60 + ___ = 80

c) 70 + 10 = ___ + 70 = 80

ç) 20 + 50 = 20 + ___ = 70

Eja të mbledhim qindëshe të plota!



1 Q + 1 Q = 2 Q

100 + 100 = 200

	Q	DH	NJ
	1	0	0
+	1	0	0
	2	0	0

1 + 1 = 2
10 + 10 = 20
100 + 100 = 200

Mbaj mend!
Gjatë mbledhjes së numrave treshifrorë me qindëshe të plota, mblidhen qindëshet, kurse në vendin e dhjetësheve dhe njësheve shkruhen zero.

2 **Njehso duke shfrytëzuar drejtëzën numerike.**



100 + 100 = 200



300 +300 = ☐



400 +300 = ☐

3 **Lidhi kornetat me topat përkatëse të akulloreve që mbledhja të jetë saktë.**



4 **Njehso:**

100 + 400 + 400 = ☐

300 + 100 + 200 = ☐

100 + 200 + 100 = ☐

100 + 400 + 500 = ☐

100 + 300 + 300 = ☐

200 + 100 + 400 = ☐

100 + 300 + 100 = ☐

100 + 400 + 100 = ☐

5 **Plotësoji rrathët e zbrazur që të fitosh shumë të saktë.**



6 **Josifi ka blerë sako për 600 denarë dhe shall për 300 denarë. Sa denarë ka shpenzuar Josifi?**

Zgjidhje:

Përgjigje: Josifi ka shpenzuar _____ denarë.

7 **Tijana ka 300 denarë. Në xhep ka gjetur edhe banknota prej 100 denarë dhe 2 banknota prej 200 denarë. Sa denarë ka Tijana?**

Zgjidhje:

Përgjigje: Tijana ka _____ denarë.



Martina ka 350 kube. Marko i ka dhënë edhe 10 kube. Sa kube ka Martina?

Zgjidhje:
350 + 10 =

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	3	5	0
+		1	0
	3	6	0

mbledhja në kolonë

$$\begin{array}{r} 350 \\ +\ \ 10 \\ \hline 360 \end{array}$$

mbledhja me zbërthim



3 Q 5 DH + 1 DH = 3 Q 6 DH = 300 + 60 = 360

Përgjigje: Martina ka _____ kube.

Mario ka 350 kube. Për ditëlindje ka marrë edhe 100 kube. Sa kube ka Mario?

Zgjidhje:
350 + 100 =

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	3	5	0
+	1	0	0
	4	5	0

mbledhja në kolonë

$$\begin{array}{r} 350 \\ +\ 100 \\ \hline 450 \end{array}$$

mbledhja me zbërthim



3Q 5 DH + 1 Q = 4 Q 5 DH = 400 + 50 = 450

Përgjigje: Mario ka _____ kube.

Mbaj mend!
Shifrat te mbledhësit të cilët qëndrojnë në pozitën (klasë) të njëjtë, shkruhen njëra nën tjetrën. Mbledhim duke filluar prej njësheve!

1 **Njehso në tabelën.**

	+ 10	+ 20	+ 100	+ 200
178				
257				
312				
441				
526				
689				
634				
753				

2 **Me ndihmën e shigjetave Njehsoji shumat.**

520 + 20 = 520 (+ 10, + 10)

140 + 50 = 140 (+ 10, + 10, + 10, + 10, + 10)

320 + 400 = 320 (+ 100, + 100, + 100, + 100)

280 + 500 = 280 (+ 100, + 100, + 100, + 100, + 100)

3 **Fillo të mbledhësh dhe shkruaj shumën te rrethi përkatës. Vazhdo më tutje! Cila është shuma e fundit?**

530 +40 +30 +80 +100 +20 = ◯





4 Te numri 450 shto shumën e numrave 50 dhe 30.

Zgjidhje:

5 Kaja ka shkruar katër numra. Më i vogli është 230, kurse çdo numër i ardhshëm është për 50 më i madh prej numrit paraprak. Cilët numra i ka shkruar Kaja?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

6 Shuma e numrave të cilët janë shkruar në anën e përparme dhe të prapme të çdo kubi është 110. Njehso shumën e numrave të anës së prapme të të gjithë kubeve.

Zgjidhje:



për shembull: 70 + ___ = 110

7 Në shkollë në klasën e parë ka 150 nxënës, në të dytën për 40 nxënës më shumë në klasën e parë, kurse në klasën e tretë 100 nxënës më shumë në klasën e dytë. Sa nxënës gjithsej ka në të tri klasat?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

CAKTIMI I NUMRIT MË TË MADH/MË TË VOGËL PËR 1, 10, 100 PREJ NUMRIT TRESHIFROR

1 **Plotësoji fushat e zbrazura.**

	79			250			319	
	500			690			999	

Çka ke vërejtur?
- Numër më i madh për 1 prej numrit të dhënë është pasardhësi i tij.
- Numër më i vogël për 1 prej numrit të dhënë është paraardhësi i tij.

2 **Njehso dhe plotëso fushat e zbrazura te majmunët.**



3 Plotësoji tabelat.

Kur te numri i dhënë caktojmë numër më të madh për 10, e zmadhojmë për 1 shifrën e dhjetësheve.
Kur te numri i dhënë caktojmë numër më të vogël për 10, e zvogëlojmë për 1 shifrën e dhjetësheve.

– 10		+ 10
	154	
	253	
	319	
	462	
	390	
	616	
	248	

Kur te numri i dhënë caktojmë numër më të madh për 100, e zmadhojmë shifrën e qindësheve.
Kur te numri i dhënë caktojmë numër më të vogël për 100, e zvogëlojmë shifrën e qindësheve.

– 100		+ 100
	253	
	483	
	319	
	191	
	537	
	658	
	490	

4 Gjeji dhe lidhi gjysmat e mollëve me shumat përkatëse!

5 Dejani ka 450 denarë, kurse Koki 100 denarë më shumë se Dejani. Sa denarë ka Koki, kurse sa denarë kanë të dy së bashku?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

6 Njehso:



MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR, DYSHIFROR DHE TRESHIFROR DERI 1 000 PA KALIM

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMLR NJËSHIFROR DERI 1 000 PA KALIM

Të njehsohet shuma e numrave 215 + 3 = ☐

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	2	1	5
+			3
	2	1	8

mbledhja në kolonë

$$\begin{array}{r} 215 \\ +\quad 3 \\ \hline 218 \end{array}$$

mbledhja me zbërthim



2 Q 1 DH 5 NJ
+ 3 NJ
= 2 Q 1 DH 8 NJ

215 + 3 = 218



Mbaj mend!

Shifrat të cilat qëndrojnë në vendin e njëjtë te numrat, i shkruajmë njërën nën tjetrën. Mbledhja kryhet duke filluar prej njësheve.

Mbledhim njëshe me njëshe

5 NJ + 3 NJ = 8 NJ

Përshkruhen shifrat e dhjetësheve dhe qindësheve prej mbledhësit të parë.

Mënyra për mbledhje me zbërthim të mbledhësve dhe me shtim:

215 + 3 = (200+10+5) + 3 = 200+10 + (5+3) = 200+10+8=218

1 **Njehso:**

a) 347 + 2 = b) 263 + 6 = c) 801 + 8 =

ç) 560 + 9 = d) 681 + 7 = dh) 472 + 5 =

2 **Njehso:**

636 —(+4)→ ☐ —(+3)→ ☐ —(+1)→ ☐ —(+6)→ ☐ —(+2)→ ☐ —(+3)→ ☐

305 —(+5)→ ☐ —(+3)→ ☐ —(+2)→ ☐ —(+5)→ ☐ —(+3)→ ☐ —(+5)→ ☐

3 Njehso shumën.





4 Mirjana bashkon enigmë. Ka bashkuar 245 pjesë. Që të jetë gati enigma duhet të bashkojë edhe 4 pjesë. Prej sa pjesë është enigma?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR DYSHIFROR DERI 1 000 PA KALIM

Të njehsohet shuma e numrave 215 +43 = ☐

mbledhja me tabelë

	Q	DH	NJ
	2	1	5
+		4	3
	2	5	8

mbledhja me kolonë

$$\begin{array}{r} 215 \\ +\ \ 43 \\ \hline 258 \end{array}$$

mbledhja me zbërthim



2 Q 1 DH 5 NJ
+ 4 DH 3 NJ
= 2 Q 5 DH 8 NJ

215 + 43 = 258



Mbaj mend!

Shifrat të cilat qëndrojnë në vendin e njëjtë te numrat, i shkruajmë njërën nën tjetrën. Mbledhja kryhet duke filluar prej njësheve.
Mbledhim njëshe me njëshe
5 NJ + 3 NJ = 8 NJ
Mbledhim dhjetëshe me dhjetëshe
1 DH + 4 DH = 5 DH
Përshkruhet shifra e qindësheve prej mbledhësit të parë.

Mënyra e mbledhjes me zbërthim dhe plotësim:
215 + 43 = (200 + 10 + 5) + (40 + 3) = 200 + (10 + 40) + (5 + 3) = 200 + 50 + 8 = 258

1 **Njehso:**

a) 267 + 22 = b) 724 + 51 = c) 562 + 37 =

ç) 103 + 71 = d) 821 + 74 = dh) 345 +23 =

2 **Lidhe shumën e shkruar te çdo kamioni me mbledhësit përkatës të shkruara te kutitë.**







3 **Njehso shumën nëse mbledhësi i parë është 621, kurse mbledhësi i dytë është shuma e numrave 32 dhe 15.**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

4 **Gorani në album ka ngjitur 113 fotografi. I kanë ngelur për të ngjitur edhe 31 fotografi. Sa fotografi gjithsej ka në album?**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

5 **Në muze ka pasur 200 vizitorë. Kanë ardhur edhe 26, kurse më vonë edhe 31. Sa vizitorë gjithsej ka pasur në muze?**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

3

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR TRESHIFROR DERI 1 000 PA KALIM

Të njehsohet shuma e numrave 215 +143 = ☐

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	2	1	5
+	1	4	3
	3	5	8

mbledhja me zbërthim

mbledhja në kolonë

```
  215
+ 143
  358
```



2 Q 1 DH 5 NJ
+ 1 Q 4 DH 3 NJ
= 3 Q 5 DH 8 NJ

215 + 143 = 358

Mbaj mend!

Shifrat të cilat qëndrojnë në vendin e njëjtë te numrat, i shkruajmë njërën nën tjetrën. Mbledhja kryhet duke filluar prej njësheve.

Mbledhim njëshe me njëshe
5 NJ + 3 NJ = 8 NJ

Mbledhim dhjetëshe me dhjetëshe
1 DH + 4 DH= 5 DH

Mbledhim qindëshe me qindëshe
2 Q + 1 Q = 3 Q

Mënyra e mbledhjes me zbërthim dhe plotësim:
215 + 143 = (200 + 100) + (10 + 40) + (5 + 8) = 300 + 50 + 8 = 358

1 **Njehso dhe plotëso tabelën.**

mbledhësi	312	420	109	537	322	701	803
mbledhësi	177	475	470	461	566	198	190
shuma							

2 **Njehso:**

a) 267 + 122 = b) 724 + 151 = c) 562 + 137 =

ç) 103 + 171 = d) 821 +174 = dh) 345 +123 =

3 Njehso sipas shembullit të parë.



	Q	DH	NJ
	1	2	3
+	1	2	6
	2	4	9



	Q	DH	NJ
+			



	Q	DH	NJ
+			



	Q	DH	NJ
+			

4 Njehsoji shumat, kurse pastaj lidhi peshqit me akuariumet të cilëve u takojnë.



- 183+113
- 231+237
- 195+404
- 186+213
- 474+325
- 109+260

5 Njehsoji shumat!

172 + 317

611 + 362

451 + 127

434 + 423

700 + 145

801 + 154

6 Milica ka kursyer para për të blerë libër. Ka pasur të kursyera 223 denarë, gjyshi i ka dhënë edhe 154 denarë. Sa denarë ka Milica?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

7 Jana ka blerë kavanoz reçeli për 345 denarë dhe çokollatë 132 denarë. Sa denarë ka shpenzuar Jana?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR, DYSHIFROR DHE TRESHIFROR DERI 1 000 ME KALIM

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR NJËSHIFROR DERI 1 000 ME KALIM

Të njehsohet shuma e numrave 143 + 8 = ☐

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	1	4	3
+			8
	1	5	11

mbledhja në kolonë

$$\begin{array}{r} {}^{1} \\ 143 \\ +\quad 8 \\ \hline 151 \end{array}$$

mbledhja me zbërthim



$$\begin{array}{r} {}^{1}\phantom{\text{DH 3 NJ}} \\ 1\text{ Q }4\text{ DH }3\text{ NJ} \\ +\qquad 8\text{ NJ} \\ \hline =1\text{ Q }5\text{ DH }1\text{ NJ} \end{array}$$

143 + 8 = 151

Mbaj mend!

Mbledhja fillon prej njësheve.

3NJ+8NJ = 11NJ = 1DH 1NJ

Shkruajmë 1 NJ, kurse 1 DH mbajmë në mend, përkatësisht e shkruajmë mbi shifrën e dhjetësheve. Dhjetëshen të cilën e mbajmë në mend e mbledhim me dhjetëshen e mbledhësit të parë.

4 DH + 1 DH = 5 DH.

Përshkruhet shifra 1 te qindëshet.

Mënyra e mbledhjes me plotësim deri te dhjetëshja e plotë:

143 + 8 = 143 + (7 + 1) = (143 + 7) + 1 = 150 + 1 = 151

1 **Njehso:**

a) 278 + 2 = b) 612 + 9 = c) 435 + 6 =

ç) 183 + 8 = d) 826 + 9 = dh) 709 + 7 =

2 **Njehso:**

a) 479 + 2 = b) 415 + 7 = c) 235 + 9 =

ç) 572 + 9 = d) 856 + 8 = dh) 504 + 7 =

3 Njehsoji shumat dhe shkruaj te reja.



4 Që peshorja të jetë në baraspeshë shkruaje shumën te katrorët e zbrazur.



5 Njehso.

+	6	5	3
268			
309			
629			

+	7	4	8
707			
418			
167			

6 Te parku zbavitës janë shitur 193 bileta paradite. Pasdite janë shitur edhe 8 bileta. Sa bileta janë shitur atë ditë te parku zbavitës?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

7 Mbledhësi i parë është 547, kurse mbledhësi i dytë është numri njëshifror më i madh tek. Njehso shumën.

Zgjidhje:

8 Lara te bredhi i vitit të ri ka vendosur 168 llamba, 9 lampionë dhe 8 fjongo. Me sa zbukurime Lara e ka zbukuruar bredhin e vitit të ri?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

3

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR DYSHIFROR DERI 1 000 ME KALIM

Të njehsohet shuma e numrave

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	2 (1)	4 (1)	8
+		8	7
	3	(1)3	(1)5

mbledhja me zbërthim



248 + 87 = ☐

mbledhja në kolonë

$$\begin{array}{r} {}^{1\,1} \\ 248 \\ +\ \ 87 \\ \hline 335 \end{array}$$

$$\begin{array}{r} {}^{1}\ {}^{1} \\ 2\,Q\ 4\,DH\ 8\,NJ \\ +\quad 8\,DH\ 7\,NJ \\ \hline =3\,Q\ 3\,DH\ 5\,NJ \end{array}$$

248 + 87 = 335

Mendo dhe vëre se si është fituar shuma. Sqaro! A mund të gruposh edhe në tjetër mënyrë? Pse?

248 + 87 = 248 + (80 + 7) = (248 + 80) + 7 = 328 + 7 = 335

Mbaj mend!

Mbledhja fillon prej njësheve.

8 NJ + 7 NJ = 15 NJ = 1DH 5NJ

Shkruajmë 5 NJ, kurse 1 DH mbajmë në mend, përkatësisht, e shkruajmë mbi shifrën e dhjetësheve dhe e mbledhim me dhjetëshet prej mbledhësve.

4 DH + 8 DH + 1 DH = 13 DH = 1Q 3DH

Shkruajmë 3 DH, kurse 1 Q mbajmë në mend, përkatësisht e shkruajmë mbi shifrën e qindësheve dhe e mbledhim me qindëshet.

2 Q + 1 Q = 3 Q

1 **Njehso:**

a) 2 Q 4 DH 7 NJ
+ 6 DH 4 NJ

b) 4 Q 7 DH 6 NJ
+ 4 DH 5 NJ

c) 8 Q 3 DH 5 NJ
+ 8 DH 5 NJ

2 Njehsoji shumat dhe shkruaji te vijat e zbrazura.



3 Njehsoji shumat te kolonat ose me plotësim, kurse pastaj lidhi!

Zgjidhje:





4 **Sa kushtojnë lojërat e Edos?**

Zgjidhje:

135 den.

58 den.



69 den.

Përgjigje: _____

5 **Formo detyrë me mbledhje sipas të dhënave te tabelat dhe zgjidhe.**

Zgjidhje:

158

49

Përgjigje: _____

6 **Sfidë! Rasho ka 326 fotografi dhe 8 xhamli, Igori ka 328 fotografi dhe 4 xhamli. Adami ka më pak fotografi se Igori, kurse më shumë se Rasho. Adami ka për 2 më shumë xhamli se Igori. Cili ka më së shumti edhe fotografi edhe xhamli së bashku?**

Zgjidhje:



Përgjigje: _____

MBLEDHJA E NUMRIT TRESHIFROR ME NUMËR TRESHIFROR DERI 1 000 ME KALIM

Të njehsohet shuma e numrave 248 + 187 = ☐

mbledhja në tabelë

	Q	DH	NJ
	2 (1)	4 (1)	8
+	1	8	7
	4	(1)3	(1)5

mbledhja me zbërthim



mbledhja në kolonë

```
  1 1
  248
+ 187
  435
```

Fillojmë prej njësheve.

	2	4	8
+	1	8	7
			5

Te shuma e njësheve kemi dhjetëshe, e mbledhim me dhjetëshet.

		1	
	2	4	8
+	1	8	7
		3	5

Te shuma e dhjetësheve kemi qindëshe, e mbledhim me qindëshet

	1	1	
	2	4	8
+	1	8	7
	4	3	5

```
  1   1
  2 Q 4 DH 8 NJ
+ 1 Q 8 DH 7 NJ
= 4 Q 3 DH 5 NJ
```

248 + 187 = 435

Gjej edhe strategji të tjera për mbledhjen e numrave treshifrorë. Për shembull, mblidh me zbërthim dhe **plotësim** deri te qindëshet dhe dhjetëshet e plota:
248+187 = (200+40+7)+(100+80+7)=(200+100)+(40+80)+(8+7)=300+(100+20) +(10+5)=(300+100)+(20+10)+5 = 400+30+5 = 435

Mbaj mend!

Mbledhja fillon prej njësheve.
8 NJ + 7 NJ = 15 NJ = 1DH 5NJ
Shkruajmë 5 NJ, kurse 1 DH mbajmë në mend, përkatësisht e shkruajmë mbi shifrën e dhjetësheve dhe e mbledhim me dhjetëshet prej mbledhësve.
4 DH + 8 DH + 1 DH = 13 DH = 1Q 3DH
Shkruajmë 3 DH, kurse 1 Q e mbajmë në mend, përkatësisht e shkruajmë mbi shifrën e qindësheve dhe e mbledhim me qindëshet.
2 Q + 1 Q + 1 Q = 4 Q

1 Njehsoji shumat e numrave.

	1	5	7
+	1	5	5

	2	3	9
+	1	9	6

	4	2	9
+	1	9	3

	3	5	3
+	1	6	8

	4	3	7
+	1	7	4

	4	2	6
+	1	9	5

2 Njehso:

a) 287 + 18 + 45 =

b) (36 + 168) + 134 =

c) 780 + 47 + 116 =

ç) 256 +482 + 60 =

d) 365 + (47 + 123) =

dh) 307 + (256 + 86) =

3 Njehsoji shumat, gjeji shportat dhe lidhi!



4 Numrit më të vogël çift prej 3. qindëshe shtoje numrin më të madh dyshifrorë. Cilin numër e fitove?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

5 Në kopshtin zoologjik ka gjithsej 146 kafshë. Është lajmëruar se do të blejnë edhe 67 kafshë, kurse 49 do të fitojnë si dhuratë. Sa kafshë gjithsej do të ketë në kopshtin zoologjik?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

6 Një ndërtesë është ndërtuar një vjet e 38 ditë. Sa ditë është ndërtuar ndërtesa?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

7 Te kampi veror kanë veruar 287 djem dhe 182 më shumë vajza se djem. Sa vajza, e sa gjithsej fëmijë kanë veruar në kampin veror?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____



Njehso shumën, nëse mbledhësit janë 200 dhe 60.

Ivani dhe Damiri detyrën e kanë zgjidhur në mënyrë të ndryshme. Cili e ka zgjidhur detyrën saktë?

Të dy kanë fituar zgjidhje të njëjtë, kurse ai është numri 260.

200 + 60 = 260 60 + 200 = 260

200 + 60 = 60 + 200

Gjatë mbledhjes, nëse mbledhësit i ndërrojnë vendet shuma nuk ndryshon. Kjo është **vetia komutative** e mbledhjes.

1 **Pa njehsuar lidhi shprehjet numerike të cilat kanë shumë të njëjtë.**





2 **Te katrorët e zbrazur shkruaji numrat të cilët mungojnë për barazim që të jenë të saktë.**

a) 400 + _____ = 30 + 400

b) _____ + 300 = 300 + 5

c) 120 + 0 = _____ + 120

ç) 80 + 700 = 700 + _____

3 **Ada ka 150 shirita të kuq dhe 40 të kaltër. Eda ka 40 shirita të kuq dhe 150 të kaltër. Sa shirita ka Ada, kurse sa Eda? Çka vëren, cila ka më shumë?**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

4 **Shkruaje vetinë komutative të mbledhjes, nëse mbledhësit janë:**

a) 54 dhe 270 b) 800 dhe 150 c) 45 dhe 355

5 **Gjeje rrugën e çdonjërit prej peshqve deri tek akuariumi. Çka vëren?**



Të përkujtohemi!

Përkujtohu në mënyrën e zbritjes së dhjetësheve të plota.



3 DH - 1 DH = 2 DH

30 – 10 = ☐

zbritje

30 – 10 = 20

i zbritshmi — zbritësi — ndryshimi

Në kolonë

	DH	NJ
	3	0
–	1	0
	—	—







10 DH - 4 DH = 6 DH

100 – ☐ = 60

	Q	DH	NJ
	~~1~~	(10) 0	0
–		4	0
		6	0

1 **Njehso!**

100 – 70 = ☐ 40 – 30 = ☐

90 – 50 = ☐ 60 – 20 = ☐

30	80	100	100
– 20	– 50	– 80	– 50
☐	☐	☐	☐

2 **I zbritshmi është 90, kurse zbritësi është 30. Sa është ndryshimi?**

Zgjidhje:

Eja të shqyrtojmë zbritje të qindësheve të plota!



Në kolonë

	Q	DH	NJ
	3	0	0
–	2	0	0
	1	0	0

3 Q - 2 Q = 1 Q ose 300 - 200 = ☐

Mbaj mend!

Edhe te zbritja fillohet me njëshet.

Gjatë zbritjes së numrave dyshifrorë me dhjetëshe të plota, zbriten dhjetëshet, kurse në vendin e njësheve shkruhet zero.

Gjatë zbritjes së numrave treshifrorë me qindëshe të plota, zbriten qindëshet, kurse në vendin e dhjetësheve dhe njësheve shkruhen zero.

3 Njehso!

$$\begin{array}{r} 900 \\ -\ 200 \\ \hline \square \end{array} \quad \begin{array}{r} \square \\ -\ 300 \\ \hline \square \end{array} \quad \begin{array}{r} \square \\ -\ 100 \\ \hline \square \end{array} \qquad \begin{array}{r} 800 \\ -\ 400 \\ \hline \square \end{array} \quad \begin{array}{r} \square \\ -\ 200 \\ \hline \square \end{array} \quad \begin{array}{r} \square \\ -\ 100 \\ \hline \square \end{array}$$

4 Njehso ndryshimin dhe shkruaj shkronjën përkatëse te tabela.

900– 100	600– 400	800– 400	700– 100	1 000– 500

400	600	800	200	500

5 Sara ka 500 denarë, ka blerë syze të cilat kanë kushtuar 400 denarë. Sa denarë i kanë ngelur Sarës?

Zgjidhje:

Përgjigje: Sarës i kanë ngelur _____ denarë.

6 Gjyshi Llazar ka pasur 1 000 kilogramë mollë. Në fund të ditës i kanë ngelur të pashitura edhe 300 kilogramë. Sa kilogramë mollë ka shitur gjyshi Llazar?

Zgjidhje:

Përgjigje: Gjyshi Llazar ka shitur _____ kilogramë mollë.

ZBRITJA E QINDËSHEVE TË PLOTA PREJ NUMRIT TRESHIFROR

Të përkujtohemi!



Në kolonë

	DH	NJ
	5	5
–	2	0
	—	—

Fillojmë të zbresim prej njësheve

5DH 5NJ – 2DH = 3DH 5NJ

55 – 20 = 35

1 **Njehso çka do të fitojë hulumtuesi prej makinave të tij për zbritje!**



Të shqyrtojmë se si do të zbresim qindëshe të plotë prej numrit treshifror!



Kur te numri shifra e parë është **0** ajo nuk shkruhet

	Q	DH	NJ
	1	4	6
–	1	0	0
	~~0~~	4	6

1 – 1 = 0 | 4 – 0 = 4 | 6 – 0 = 6

1Q 4DH 6NJ – 1Q = ☐DH ☐NJ

146 – 100 = 46

Mbaj mend!

Gjatë zbritjes së numrave dyshifrorë me dhjetëshe të plota, fillohet prej njësheve, kurse pastaj zbriten dhjetëshet.

Gjatë zbritjes së numrave dyshifrorë me qindëshe të plota, fillohet prej njësheve, kurse pastaj zbriten dhjetëshet dhe në fund zbriten qindëshet.

2 Njehso ndryshimin, pastaj ngjyros nëndetësen sipas ngjyrave të dhëna.



90 260 350 480

3 Vazhdo vargun duke njehsuar ndryshimin e numrave.

– 200 – 100 – 300 – 200 – 100

990 → ◯ → ◯ → 390 → ◯ → ◯

– 100 – 200 – 200 – 100 – 200

864 → ◯ → 564 → ◯ → ◯ → ◯

4 Në një autobus kanë udhëtuar 210 udhëtarë. Te stacioni i parë kanë zbritur 100 prej udhëtarëve. Sa udhëtar e kanë vazhduar udhëtimin me autobus?

Zgjidhje:

Përgjigje: Udhëtimin me autobus e kanë vazhduar _____ udhëtarë.

5 Ndryshimin e numrave 450 dhe 200, zvogëloje për 100. Cilin numër e fitove?

Zgjidhje:

Përgjigje: E fitova numrin _____ .

6 Në festën e ditëlindjes kanë arritur 540 mysafirë. Prej mysafirëve 300 kanë pirë lëng pjeshkash, mysafirët e tjerë kanë pirë lëng prej portokalli. Sa mysafirë kanë pirë lëng prej portokalli? Prej cilit lëng më shumë kanë pirë mysafirët?

Zgjidhje:

Përgjigje: Lëng prej portokalli kanë pirë _____ mysafirë.
Shumica e mysafirëve kanë pirë lëng prej _____ .

Ta shqyrtojmë se si zbriten dhjetëshet e plota prej numrit treshifror.



4Q 3DH 4NJ – 2DH = 4Q 1DH 4NJ
434 – 20 = 414

	Q	DH	NJ
	4	3	4
–		2	0

4NJ – 0NJ = 4NJ

4Q

3DH – 2DH = 1DH

Mbaj mend!
Gjatë zbritjes së dhjetëshes së plotë prej numrit treshifror, fillojmë prej njësheve, pastaj i zbresim dhjetëshet dhe në fund qindëshet i përshkruajmë.

1 **Njehso!**

674 – 70 =	398 – 60 =	444 – 10 =	580 – 80 =	210 – 10 =

Ta shqyrtojmë shembullin 305 – 70 =?

Q DH NJ

Zbresim prej njësheve 5 – 0 = 5



Huazojmë prej qindëshes. 100 – 70 = 30



Në fund të dy qindëshet i përshkruajmë.
200

Fillojmë prej njësheve.

	3	0	5
–		7	0
			5

Çka të bëjmë, kur nuk ka dhjetëshe? Huazojmë prej qindësheve te e cila ka dhjetë dhjetëshe.

2 10

	~~3~~	0	5
–		7	0
		3	5

5NJ – 0NJ = 5NJ
10DH – 7DH = 3DH
2Q

	3	0	5
–		7	0
	2	3	5

2 **Zbatoje njohurinë e re te shembujt e dhënë.**

710 – 20 = ☐
630 – 50= ☐

920
– 30
☐

430
– 40
☐

254 – 70 = ☐
369 – 80= ☐

3 **Njehso ndryshimet e numrave dhe shkronja që i përgjigjet shkruaje te rrethi. Lexo cilën fjalë e fitove!**

480 – 60 = ☐ ○
570 – 40 = ☐ ○
346 – 20 = ☐ ○
255 – 50 = ☐ ○
760 – 60 = ☐ ○
816 – 10 = ☐ ○

530	E
700	R
806	A
420	D
326	T
205	Y

fjalën:

4 **Te vrapimi atletik janë paraqitur 190 atletë. Gjatë vrapimit 80 atletë janë larguar. Sa prej atletëve kanë arritur te caku?**

Atletë të paraqitur: _____
Janë larguar gjatë vrapimit: _____
Kanë arritur te caku: _____

Q	DH	NJ

Përgjigje: Te caku kanë arritur _____ atletë.

5 **Bobi dëshiron të blejë fotoaparat i cili kushto 230 euro. Ai prej gjyshes ka marrë 80 euro. Sa euro duhet të shtojë prej kursimit të tij për ta blerë fotoaparatin?**

Fotoaparati kushto: _____
Prej gjyshes ka marrë: _____
Prej kursimit të marrë: _____

Q	DH	NJ

Përgjigje: Prej kursimit duhet të marrë _____ euro.

ZBRITJA E NUMRIT NJËSHIFROR PREJ NUMRIT TRESHIFROR

Të njehsohet ndryshimi i numrave 403 - 3 = ☐



	Q	DH	NJ
	4	0	3
–	↓	↓	3
			0

4Q 3NJ – 3NJ = 4Q

403 – 3= ☐

4Q | 0DH | 3NJ – 3NJ = 0NJ

1 Sa mjaltë kanë mbledhur bletët në sëndukun e tyre?



Shembuj kur huazojmë (me kalim).

	4	2	0
–			6

→

	4	~~2~~ (1)	0 (10)
–	↓	↓	6
	4	1	4

4Q | 1DH | 10NJ – 6NJ = 4NJ

	3	0	1
–			7

	~~3~~ (2)	~~0~~ (9)	1 (11)
–	↓	↓	7
	2	9	4

2Q | 9DH | 11NJ – 7NJ = 4NJ

ZBRITJA E NUMRIT DYSHIFROR PREJ NUMRIT TRESHIFROR

Të njehsohet ndryshimi i numrave 545 – 32 = ☐



	Q	DH	NJ
	5	4	5
–		3	2

5Q 4DH 5NJ – 3DH 2NJ = 5Q 1DH 3NJ

5Q | 4DH – 3DH = 1DH | 5NJ – 2NJ = 3NJ

Si është realizuar zbritja më poshtë?

545 - 32 = (500 + 40 + 2) - (30 + 2) = 500 + (40 - 30) + (5 - 2) = 500 + 10 + 3 = 513

Mbaj mend!

Gjatë zbritjes së numrit njëshifror prej numrit treshifror fillohet prej njësheve, kurse pastaj zbriten dhjetëshet dhe në fund qindëshet.
Nëse njëshet te numri treshifror janë më të vegjël prej numrit njëshifror, atëherë huazojmë prej dhjetësheve, e nëse shifra e dhjetësheve është 0, huazojmë një qindëshe dhe ajo bëhet 10 dhjetëshe.
Ky rregull vlen edhe gjatë zbritjes së numrit dyshifror dhe treshifror prej numrit treshifror.

2

349 − 35	650 − 10	487 − 67	262 − 51
I	Z	J	R
832 − 43	456 − 77	934 − 55	633 − 64
B	E	T	T

640	
789	
211	
314	
879	
420	
379	
569	

3 **Numrin 526 zvogëloje për 19, kurse pastaj numrin e fituar zvogëloje për 49.**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

4 **Nëse në një vit që nuk është i brishtë 78 ditë do t'i kalosh mysafir te gjyshja dhe gjyshi, sa ditë të vitit je në shtëpi?**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

ZBRITJA E NUMRIT TRESHIFROR PREJ NUMRIT TRESHIFROR

Të njehsohet ndryshimi i numrave **265 – 242 = ☐**



	Q	DH	NJ
	2	6	5
−	2	4	2

2Q 6DH 5NJ – 2Q 4DH 2NJ = 0Q 2DH 3NJ

265 – 242 = ☐

2Q -2Q = 0Q | 6DH – 4DH = 2DH | 5NJ – 2NJ = 3NJ

5 **Plotësoje tabelën!**

i zbritshmi	850	290	300	710
zbritësi	434	280	180	700
ndryshimi				

6 **Sara dhe Lara mbledhin bonbone. Sara ka 977, kurse Lara ka 8 bonbone më pak se Sara. Sa bonbone ka Lara?**



Njehso në kolonë



Përgjigje: Lara ka _____ bonbone.

7 **Në një fabrikë për këpucë në janar janë prodhuar 730 çifte të këpucëve. Muajin vijues janë prodhuar 90 çifte të këpucëve më pak se në muajin paraprak. Sa këpucë janë prodhuar në muajin shkurt?**



Njehso në kolonë



Përgjigje: Në shkurt janë prodhuar _____ çifte të këpucëve.

8 **Davidi lexon libër prej 345 faqeve. Për një javë ka lexuar 296 faqe. Edhe sa faqe duhet të lexojë Davidi për ta mbaruar leximin?**

Libri ka: ☐
Davidi ka lexuar: ☐
Duhet të lexojë edhe: ☐

Njehso në kolonë



Përgjigje: Davidi duhet të lexojë edhe _____ faqe.

CAKTIMI I NUMRIT TË PANJOHUR GJATË MBLEDHJES DHE ZBRITJES DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Në klasën e Anjës ka 13 vajza. Numri i përgjithshëm i nxënësve është 27. Sa djem ka në klasë?

vajza + djem = gjithsej nxënës

13 + [?] = 27 → 13 + [ ] = 27

mbledhësi i panjohur

[ ] = 27 – 13

[ ] = 14

Përgjigje: _____

Me kontroll konstatojmë se a e kemi zgjidhur saktë.

Kontrolli: 13 + 14 = 27

Mbaj mend!

Mbledhësi i panjohur caktohet nëse prej shumës zbritet mbledhësi i panjohur.

1 **Njehso mbledhësin e panjohur.**

a) 128 + [ ] = 362
[ ] =
[ ] =
Kontrolli:

b) [ ] + 285 = 730

c) [ ] + 198 = 412

ç) 300 + [ ] = 539
[ ] =
[ ] =
Kontrolli:

d) [ ] + 676 = 1 000

dh) 455 + [ ] = 630

2 **Ndaj cilit numër duhet të shtohet numri 137 për t'u fituar numri 720?**

Zgjidhje:

Përgjigje: Numri 137 duhet të shtohet ndaj numrit _____

3 **Në një fuçi ka 358 litra ujë. Nëse fuçia nxë 800 litra, edhe sa litra ujë duhet të futen që fuçia të mbushet?**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

4 **Sfida! Mbledhësi i parë është shuma e numrave 200 dhe 145, kurse shuma është 650. Cakto mbledhësin e dytë.**

Zgjidhje:

Përgjigje: Mbledhësi i dytë është _____

Të përkujtohemi!

Maja ka marrë 32 mollë, kurse të tjerat 60 i ka marrë Suada. Sa mollë ka pasur në shportë?

Numri i mollëve në shportë në fillim është i panjohur. E shënojmë me drejtkëndësh të zbrazur ☐.

gjithsej mollë – mollët e Majës = mollët e Suadës

☐ – 32 = 60

I zbritshmi i panjohur

☐ – 32 = 60
☐ = 60 + 32
☐ = 92

Përgjigje: Në shport ka pasur _____ mollë.

Kontrolli: 92 – 32 = 60

Mbaj mend!
I zbritshmi i panjohur gjendet nëse mblidhen zbritësi dhe ndryshimi.

1 **Njehso të zbritshmin e panjohur.**

a) ☐ – 260 = 130
☐ =
☐ =
Kontrolli:

b) ☐ – 144 = 370

c) ☐ – 590 = 250

ç) ☐ – 350 = 570
☐ =
☐ =
Kontrolli:

d) ☐ – 135 = 432

dh) ☐ – 420 = 56

2 **Prej cilit numër duhet të zbritet numri 313 që të fitohet numri 192.**

Zgjidhje:

Përgjigje: Duhet të zbritet prej numrit _____

Të përkujtohemi!

Sara ka lexuar lektyrën prej 150 faqeve. Ajo fillon të lexojë dhe i kanë ngelur edhe 64 faqe për të lexuar. Sa faqe prej lektyrës ka lexuar Sara?

gjithsej faqe – faqet e lexuara = faqet për të lexuar

150 – ☐ = 64

zbritësi i panjohur

150 - ☐ = 64

☐ = 150 - 64

☐ = 86

Kontrolli: 150 – 86 = 64

Mbaj mend!

Zbritësi i panjohur gjendet nëse prej të zbritshmit zbritet ndryshimi.

1 **Njehso:**

a) 740 – ☐ = 270

☐ =

☐ =

Kontrolli:

b) 675 – ☐ = 590

c) 810 – ☐ =645

ç) 389 – ☐ = 120

☐ =

☐ =

Kontrolli:

d) 549 – ☐ = 350

dh) 761 – ☐ = 290

2 **Cili numër duhet të zbritet prej 700, që të fitohet 275?**

Zgjidhje: Përgjigje: _____

3 **Për sa duhet të zvogëlohet ndryshimi i numrave 600 dhe 125, që të fitohet 234.**

Zgjidhje: Përgjigje: _____

4 **Gjyshja Savka në treg ka dërguar për shitje 270 kilogramë domate. Ka shitur prej domateve, kurse në shtëpi ka kthyer 39 kilogramë. Sa kilogramë domate ka shitur gjyshja Savka?**

Zgjidhje: Përgjigje: _____

1 Njehso.



2 Cakto shifrat e panjohura te numrat që shumat të jenë të sakta.

2□4	□72	2□6	□5□	□□8	2□□
+543	+409	+485	+487	+388	+562
807	781	691	846	776	861

3 Në dy pishina ka pasur gjithsej 132 fëmijë. Te njëri ka pasur 48 më shumë fëmijë prej pishinës tjetër. Nga sa fëmijë ka pasur në të dy pishinat?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

_____

_____

4 **Në një shitore ditën e parë janë porositur 135 çokollata. Ditën e dytë janë porositur 50 çokollata më shumë se ditën e parë, kurse ditën e tretë janë porositur për 200 më shumë se ditën e parë dhe të dytë së bashku. Njehso numrin e përgjithshëm të çokollatave të cilat janë porositur për tri ditë?**

Zgjidhje: Përgjigje: _____

_____

_____

5 **Fletorja dhe lapsi kushtojnë 62 denarë, kurse fletorja dhe dy lapsa kushtojnë 85 denarë. Sa denarë kushton një fletore?**

Zgjidhje: Përgjigje: _____

_____

_____

6 **Formo detyrë tekstuale sipas të dhënave dhe zgjidhe.**


50 den.


40 den.

Zgjidhje:

20 den.


30 den.

80 den.

Përgjigje: _____

DYFISHIMI DHE PËRGJYSMIMI I NUMRAVE DERI 1 000

DYFISHIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ QINDËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Maja dhe Mahiri kanë luajtur pikado. Gjatë hedhjes së parë, numrat të cilët i kanë qëlluar me shigjetë, i kanë dyfishuar. Cili ka qëlluar numër më të madh dhe sa është numri i dyfishuar?

Maja ka qëlluar numrin 10 , kurse i dyfishuar është _____.
Mahiri ka qëlluar numrin 20 , kurse i dyfishuar është _____.

Mbaj mend!
Dyfishimi i një numri do të thotë numrin ta mbledhim me vetveten ose ta shumëzojmë me dy.

1 **Shkruaji numrat nëse janë dhënë numrat e dyfishuar!**



2 Plotësoji rrathët e bredhit.
Fillo prej poshtë lart!
Çka ke vërejtur?

Sqarim:



3 **Njehso shumën e numrave të cilët të dyfishuar janë 200 dhe 600.**

Zgjidhje:

4 Plotësoje tabelën.

100	400	200
300	500	50

dyfisho →

200		

5 Nikolla për 2 minuta ka vrapuar 100 metra, kurse Jani ka vrapuar dy herë më shumë se Nikolla. Sa metra ka vrapuar Jani?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

6 Në garën nga matematika Ivo ka fituar 200 pikë, që është dyfish më shumë prej pikëve që i ka fituar Filipi. Sa pikë ka fituar Filipi? Sa kanë fituar së bashku?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____



PËRGJYSMIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ QINDËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Maja dhe Mahiri kanë vazhduar të luajnë pikado. Gjatë hedhjes së dytë, numrat të cilët i kanë qëlluar me shigjetë, i kanë përgjysmuar. Cili ka qëlluar numër më të madh dhe sa është numri i përgjysmuar?

Maja ka qëlluar numrin 20, kurse i përgjysmuar është ____.
Mahiri ka qëlluar numrin 10, kurse i përgjysmuar është ____.

Mbaj mend!

Përgjysmimi i një numri do të thotë numrin ta ndajmë përgjysmë, përkatësisht ta pjesëtojmë me numrin dy.

1 **Çdo numër prej anës së majtë të fluturës, përgjysmoje dhe shkruaje në format e njëjta prej anës së djathtë.**



2 **Përgjysmoji numrat të shënuar te figurat me dinosaurët.**



3 Njehso dhe përgjysmo shumën.

200+400
= ☐
i përgjysmuar
☐

100+300
= ☐
i përgjysmuar
☐

300+500
= ☐
i përgjysmuar
☐

600+400
= ☐
i përgjysmuar
☐

4 Duke përgjysmuar numrat formo varg numerik.



5 Petriti çdo ditë kalon nga 600 metra prej shtëpisë deri në shkollë dhe prej shkollës deri në shtëpi. Sa metra kalon Petriti në një drejtim?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

DYFISHIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ DHJETËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Ta dyfishojmë numrin 240.

Që më lehtë të dyfishohet, do ta zbërthejmë numrin në qindëshe dhe dhjetëshe:

240 = 200 + 40

Do ta dyfishojmë së pari numrin 200: 200 + 200 = 400

Pastaj do ta dyfishojmë numrin 40: 40 + 40 = 80

Pastaj i mbledhim numrat e dyfishuar: 400 + 80 = 480



Domethënë, dyfish prej 240 është 480.

1 **Dyfisho numrat sipas shembullit.**













2 Dyfishoji numrat te retë. Numrat e dyfishuar shkruaj te vagonët.



3 Xhaxhai Mite ditën e shtunë në treg ka shitur 120 kilogramë lakra. Ditën e diel ka shitur dyfish më shumë kilogramë lakra se të shutnën. Sa kilogramë lakër ka shitur të dielën? Sa kilogramë lakra ka shitur të dy ditët?

Zgjidhje: e shtunë –
e diel –
e shtunë + e diel –

Përgjigje: _____

4 Ana dhe Anja janë binake. U kanë blerë kapela dhe shalla: kapela e cila kushton 240 denarë dhe shalli ii cili kushton 120 denarë. Sa denarë kushtojnë kapelat dhe shallat për Anën dhe Anjën?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

PËRGJYSMIMI I NUMRAVE TRESHIFRORË PREJ DHJETËSHEVE TË PLOTA DERI 1 000

Të përkujtohemi!

Ta përgjysmojmë numrin 480.

Që më lehtë të jetë përgjysmimi, numrin do ta zbërthejmë në qindëshe dhe dhjetëshe.

480 = 400 + 80

Numri 400 i përgjysmuar është 200.

Numri 80 i përgjysmuar është 40.

Pastaj i mbledhim numrat e përgjysmuar: 200 + 40 =240

Gjysma prej 480 është 240.

1 **Pastaj i mbledhim numrat e përgjysmuar.**



2 **Duke i përgjysmuar numrat formo varg numerik.**

3 Përgjysmoji dhe shkruaji numrat.

120 → 60, 60	460 → ___, ___	180 → ___, ___	860 → ___, ___
660 → ___, ___	700 → ___, ___	820 → ___, ___	380 → ___, ___

4 Përgjysmo dhe dyfisho. Sipas shembullit, përgjysmoji dhe dyfishoji numrat e shkruar te figurat!

50	100	200	___ 220 ___
___	160	___	___ 240 ___
___	300	___	___ 380 ___
___	100	___	___ 500 ___

5 Te biblioteka e shkollës ka pasur 900 libra. Librat duhet të renditen në dy rafte. Nga sa libra do të ketë në çdo raft?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 DHE 10

SHUMËZIMI I NUMRIT NJËSHIFROR ME 1, 2, 3, 4, 5, 6, 9 DHE 10

Të përkujtohemi!

Të numërojmë në sa rreshta dhe kolona janë renditur bonbonet!

Në katër rreshta kemi nga 2 bonbone.

2 + 2 + 2 + 2 = 8

Gjithsej 8



Në dy kolona nga 4 bonbone.

4 + 4 = 8

Gjithsej 8

2 + 2 + 2 + 2 = 4 + 4
8 = 8

Njehso sa flutura ka te figura?

2 + 2 + 2 = 6

mbledhës — shuma

Mbaj mend!

Mbledhja e mbledhësve të njëjtë quhet **shumëzim**. Për këtë operacion shfrytëzohet shenja për shumëzim • Rezultati prej shumëzimit quhet **prodhim**.

3 • 2 = 6 — prodhimi

shumëzues — shumëzues

shenja për shumëzim

1 **Lidhi që të fitosh barazime të sakta.**

9 • 2	5+5+5+5+5+5+5	20
4 • 4	5+5+5+5	60
4 • 1	10+10+10+10+10+10	18
7 • 5	4+4+4+4	16
6 • 10	1+1+1+1	35
4 • 5	2+2+2+2+2+2+2+2+2	4



2 **Plotëso si është filluar dhe njehso.**

	$5 + 5 + 5 = 15$ $3 \cdot 5 = 15$
	
	
	

3 **Në 8 rafte ka pasur nga 2 libra. Shkruaj si:**

a) shumë me mbledhës të barabartë

b) prodhim

4 **Në çdo rreth të zbrazur vendo njërën prej shenjave <, =, > që të jetë saktë.**

a) $3 \cdot 2$ ◯ $2 + 2 + 2$

b) $8 + 8 + 8 + 8 + 8$ ◯ $8 \cdot 5$

c) $6 \cdot 10$ ◯ $10 + 10 + 10 + 10 + 10$

ç) $5 \cdot 4$ ◯ $5 + 5 + 5$

d) $5 \cdot 10$ ◯ $10 + 10 + 10$

dh) $1 \cdot 4$ ◯ $5 + 5 + 5$

Të përkujtohemi!

Maja ka 8 kube dhe i ka ndarë në 2 kutija në mënyrë të barabartë. Nga sa kube ka në çdo kuti?



gjithsej kube

numri i kutive

kube në një kuti

8 : 2 = 4

herësi

i pjesëtueshmi

pjesëtuesi

shenja e pjesëtimit

Vëre!
Cila është lidhja ndërmjet pjesëtimit dhe shumëzimit?
8:2=4 sepse 4 • 2 = 8.

1 Sipas kërkesave, ndaji pemët në pjesë të barabarta.
Nga sa pemë ka në çdo pjesë?

☐ : 2 = ☐

Përgjigje: _____

☐ : 4 = ☐

Përgjigje: _____



☐ : 2 = ☐

Përgjigje: _____

2 Sipas figurës shkruaje pjesëtimin.

Përgjigje: _____

Përgjigje: _____



Përgjigje: _____

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 1

1 Kryeje shumëzimin me 1 te rrethi i filluar!



2 Njehso me pjesëtim!

5 : 1 = 5
9 : 1 =
3 : 1 =
7 : 1 =
4 : 1 =
10 : 1 =
2 : 1 =
8 : 1 =
6 : 1 =
1 : 1 =

3 Vendo shenjën ✓ nëse është i saktë barazimi, ose ✗ nëse është gabim!

a) 1+1+1+1 = 3 · 1 ◯

b) 1+1 +1+1+1+ 1+1 +1+1+1 = 9 · 1 ◯

c) 6 · 1 = 1+1 +1+1+1 +1 ◯

ç) 5 ·1 = 1+1 +1+1+1 ◯

d) 1+1 +1+1+1+1+1 = 7 · 1 ◯

dh) 4 · 1 = 1 · 4 ◯

4 Njehso dhe shkruaj që të jetë saktë!

4 $\xrightarrow[\cdot 1]{:1}$ ☐ 6 $\xrightarrow[\cdot 1]{:1}$ ☐ 9 $\xrightarrow[\cdot 1]{:1}$ ☐ 7 $\xrightarrow[\cdot 1]{:1}$ ☐

5 Treni ka 6 vagonë. Në çdo vagon ka vend vetëm për një udhëtar. Sa udhëtarë ka gjithë treni?

Përgjigje: Te treni ka _____ udhëtarë.



☐ · ☐ = ☐

1 Ndihmoji Robit ta kryejë tabelën e shumëzimit me 2





2 Njehso nga sa dardha janë përdorur për çdo kavanoz me marmelatë!

3 Ngjyros fushat të cilat i fiton kur shumëzon me numrin 2.

2	10	11	18	8	17	21	20	19	23
4	12	13	7	5	6	14	3	16	1

4 Njehso dhe lidh!

16 : 2 • • 10

7 · 2 • • 8

20 : 2 • • 14

8 : 2 • • 18

9 · 2 • • 10

5 · 2 • • 4

5 Gjyshi Llazar ka 18 trëndafila dhe dëshiron t'i vendosë në dy vazo në mënyrë të barabartë. Nga sa trëndafila do të ketë në çdo vazo?

Përgjigje: Në çdo vazo do të ketë _____ trëndafila.

1 Shto nga 4 dhe kryeje tabelën e shumëzimit.



2 Shkruaje herësin gjatë pjesëtimit me 4!



3 Ngjyrosi numrat të cilët fitohen si prodhime gjatë shumëzimit me 4.

4	5	8	13	12	16	18	20	23	24
28	30	32	33	36	37	39	40	41	35

4 Njehso dhe zbulo si është llamba e Alajdinit tek e cila është shpirti i mirë!

4 · 4 = ____ Ë
24 : 4 = ____ A
8 · 4 = ____ E
40 : 4 = ____ P
7 · 4 = ____ M
8 : 4 = ____ S
3 · 4 = ____ GJ
9 · 4 = ____ E

28	6	12	32	10	16	2	36

5 Para ringishpilit ka 36 fëmijë të cilët presin të hipin. Në çdo shportë të ringishpilit ka vend për 4 fëmijë. Sa shporta do të jenë të zëna?

Përgjigje: Do të jenë të zëna _____ shporta të ringishpilit.

1 Plotësoji pjesët prej rrethit me prodhimet kur shumëzon me 5!





2 Caktoji herësit gjatë pjesëtimit me 5.

5 : 5 = 1
15 : 5 =
25 : 5 =
30 : 5 =
20 : 5 =
10 : 5 =
35 : 5 =
45 : 5 =
40 : 5 =
35 : 7 =

3 Gjeji prodhimet e mundshme gjatë shumëzimit me 5.

1	5	8	15	9	25	18	20	33	24
10	30	22	17	35	45	50	40	37	36

4 Njehso, kurse pastaj rrethoje numrin e saktë

25 : 5 =	10	5	45 : 5 =	8	9	2 · 5 =	10	15
4 · 5 =	20	15	10 · 5 =	50	5	15 : 5 =	3	1
6 · 5 =	3	30	35 : 5 =	7	6	8 · 5 =	40	35

5 Në oborr ka 30 fëmijë të cilët dëshirojnë të luajnë basketboll. Ata kanë formuar ekipe prej nga 5 fëmijë. Sa ekipe janë formuar?

Zgjidhje:

Përgjigje: Janë formuar _____ ekipe.

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 10

1 Eja të shumëzojmë me numrin 10!



2 Lidhi që të jetë saktë!

3 Njehso!

8 · ___ = 80	9 · ___ = 90	40 : 10 = ___	2 · ___ = 20
90 : 10 = ___	70 : 10 = ___	6 · 10 = ___	100 : ___ = 10
5 · 10 = ___	30 : 10 = ___	5 · ___ = 50	10 : ___ = 1

4 Përcille shigjetën dhe zbato shumëzimin dhe pjesëtimin me 10!



5 Stefani mbledh lule dhe dëshiron të bëjë dy buketa prej nga 10 lule. Sa lule gjithsej i duhen Stefanit për t'i bërë dy buketa?

Përgjigje: Stefanit i duhen _____ lule për të bërë buketat.

VAZHDOJMË ME SHUMËZIMIN DHE PJESËTIMIN

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 3

1 Të numërojmë me hap 3 përpara dhe 3 prapa.

+ 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3

0 3 ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

– 3 – 3 – 3 – 3 – 3 – 3 – 3 – 3 – 3 – 3

30 ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐ ☐

2 Iva, që të mësojë të shumëzojë me numrin 3, ka mbledhur tërfilë me nga tri gjethe.
Sa gjethe gjithsej kanë tërfilët të cilat i ka mbledhura Iva?

3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3 = ☐

10 · 3 = ☐

T'i ndihmojmë Ivës më lehtë të mbledhë mbledhës të barabartë?

Nëpërmjet mbledhjes së mbledhësve të barabartë mësove të shumëzosh me numrin 3.

3	3	1 · 3
3 + 3	6	2 · 3
3 + 3 + 3		3 · 3
3 + 3+ 3 + 3		4 · 3
3 + 3+ 3 + 3 + 3		5 · 3
3 + 3+ 3 + 3 + 3 + 3		6 · 3
3 + 3+ 3 + 3 + 3 + 3 + 3		7 · 3
3 + 3+ 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3		8 · 3
3 + 3+ 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3+ 3		9 · 3
3 + 3+ 3 + 3 + 3 + 3 + 3 + 3+ 3 + 3		10 · 3



Vëre!

Pjesëtimi është operacion i kundërt prej shumëzimit.

12 : 3 = 4 pasi që 4 · 3 = 12

1 **Shkruaje shumëzimin e çdonjërës prej figurave.**



____ · ____ = ____



____ · ____ = ____



____ · ____ = ____

2 Njehso dhe me simbolet për krahasim <, =, >, krahasoji shprehjet numerike.

$3 \cdot 3$ ☐ $3 + 3 + 3$ 15 ☐ $5 \cdot 3$ $8 \cdot 3$ ☐ $6 \cdot 4$

$24 : 3$ ☐ $24 : 4$ $10 + 10 + 10$ ☐ $3 \cdot 10$ $14 + 14$ ☐ $7 \cdot 4$

$(31 - 26) \cdot 3$ ☐ $3 + (3 \cdot 3)$ $42 - (18 : 3)$ ☐ $(9 : 3) \cdot 10$

3 Plotësoji numrat të cilët mungojnë:



4 Plotësoje tabelën:

:	15	21	27	30	18	9
3						

5 Petriti ka 3 vjet. Kola ka tri herë më shumë se ai, kurse babai i tyre 10 herë më shumë se Petriti. Sa vjet ka Kola, kurse sa vjet babai i tyre?

Zgjidhje:

Përgjigje: Kola ka _____ vjet, kurse babai i tyre ka _____ vjet.

6 Tre fëmijë kanë blerë 24 fotografi. I kanë ndarë në mënyrë të barabartë. Nga sa fotografi ka marrë çdo fëmijë?

Zgjidhje:

Përgjigje: Çdo fëmijë ka marrë nga _____ fotografi.

7 Sa ditë kanë tri javë?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

Nëpërmjet mbledhjes së mbledhësve të barabartë, mësove të shumëzosh me numrin 6.

6	6	1 · 6
6 + 6	12	2 · 6
6 + 6 + 6		3 · 6
6 + 6 + 6 + 6		4 · 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6		5 · 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6		6 · 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6		7 · 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6		8 · 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6+ 6		9 · 6
6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6+ 6 + 6		10 · 6

Eda i ka ndihmuar gjyshes që t'i përgatit shportat për në treg. Çdo shportë nxë nga 6 mollë.
Sa mollë gjithsej ka në të gjitha shportat?

6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 + 6 = ☐

10 · 6 = ☐

Fillojmë me 6 dhe çdo shume vijuese i shtojmë 6.

6
6 + 6 = 12 = 2 · 6
6 + 6 + 6 = 18 = 3 · 6
6 + 6 + 6 + 6 = 24 = 4 · 6
...







Ke vërejtur se pjesëtimi është operacion i kundërt i shumëzimit.

$12 : 6 = 2$

pasi që $2 \cdot 6 = 12$

Mundesh edhe vetë ta shkruash tabelën e pjesëtimit me 6.

1 **Rrethoji prodhimet dhe herësi te saktë.**





36 : 6		
5	6	7

30 : 6		
5	6	7

42 : 6		
6	7	8

12 : 6		
6	2	3

60 : 6		
5	10	6

6 : 6		
5	6	1

2 **Njehso dhe me simbolet për krahasim <, =, >, krahasoji shprehjet numerike.**

$6 + 6 + 6 + 6 + 6$ ◯ $6 \cdot 4$ $\quad$ $12 : 6 + 10$ ◯ $6 \cdot 2$ $\quad$ $54 : 6$ ◯ $3 \cdot 6$

$8 \cdot 6$ ◯ $40 + 1 \cdot 6$ $\quad$ $7 \cdot 6$ ◯ $8 \cdot 6 - 6$ $\quad$ $4 \cdot 6$ ◯ $8 \cdot 3$

3 **Plotëso që të jetë i saktë gjykimi:**

Numri 36 është _____ here më i madh se numri 6.

Gjashtë here më i vogël se numri 48 është numri _____ .

Numri 54 është për 6 më i vogël se numri _____ .



4 Herësin e numrave 54 dhe 6 zmadhoje për prodhimin e numrave 7 dhe 6.

Zgjidhje:

5 Ada ka mbledhur 30 karrota. Gjashtë karrota ka lënë në shtëpi, kurse të tjerat ua ka ndarë 4 lepujve në mënyrë të barabartë. Nga sa karrota ka çdo lepur?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

6 Sipas figurës formo detyrë tekstuale dhe zgjidhe.



Zgjidhje:

Përgjigje: _____

SHUMËZIMI DHE PJESËTIMI ME NUMRIN 9

T'i ndihmojmë Larës të mbledhë mbledhës të barabartë?

18 : 9 = 2 pasi që 2 · 9 = 18
Mund ta shkruash tabelën e pjesëtimit me 9.

Nëpërmjet mbledhjes së mbledhësve të barabartë, mësove të shumëzosh me numrin 9.

9	9	1 · 9
9+9	18	2 · 9
9+9+9		3 · 9
9+9+9+9		4 · 9
9+9+9+9+9		5 · 9
9+9+9+9+9+9		6 · 9
9+9+9+9+9+9+9		7 · 9
9+9+9+9+9+9+9+9		8 · 9
9+9+9+9+9+9+9+9+9		9 · 9
9+9+9+9+9+9+9+9+9+9		10 · 9





Lara dhe nëna e saj për Pashkët kanë ngjyrosur vezë në ngjyra të ndryshme. Vezët i kanë renditur në mënyrë të barabartë, në çdo shportë nga 9 vezë.
Sa vezë gjithsej kanë ngjyrosur Lara dhe nëna e saj?

9+9+9+9+9+9+9+9+9+9= ☐

9 · 10 = ☐

1 Plotësoje tabelën.

·	6	3	9
1			
10			
5			
2			
3			
6			
9			

2 Njehso herësin, shkruaj si te shembulli.



3 Si është fituar numri te retë? Mendo dhe shkruaj.



Zgjidhje:

$10 \cdot 9 + 10 = 90 + 10 = 100$



Zgjidhje:



Zgjidhje:

4 **Njehso:**

$(3 \cdot 9) + (5 \cdot 9) =$

$8 \cdot 9 + \square = 100$

$(63 : 9) + (54 : 6) =$

$10 \cdot 9 - \square = 25$

Shkruaj dhe njehso numrin i cili është:

6 herë më i vogël se numri 54 _____

9 herë më i vogël se 90 _____

5 herë më i vogël se 45 _____

Për 9 më i vogël se 63 _____

Për 5 më i vogël se 30 _____

5 **Aleku ka 54 xhamli, Ivani ka 9 xhamli më pak se Aleku, kurse Gorani ka 9 herë më pak xhamli se Aleku. Sa xhamli ka Ivani, kurse sa xhamli ka Gorani?**

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

6 **Davidi dhe Edoja kanë blerë lapsa me çmim të njëjtë. Davidi ka blerë 9 lapsa dhe ka paguar 63 denarë.**
Edoja ka blerë 5 lapsa. Sa kushton një laps dhe sa ka paguar Edoja për lapsat?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

SHUMËZIMI I NUMRIT DYSHIFROR ME 10

Të përkujtohemi!

Në një kopsht pemësh në 12 rreshta janë mbjellë nga 10 fidanë mollë. Sa fidanë mollë gjithsej ka në kopshtin e pemëve?

$12 \cdot 10 = 120$

Përgjigje: Në kopshtin e pemëve ka _____ fidanë.

Mbaj mend!

Kur numri i dhënë shumëzohet me 10, ai bëhet 10 herë më i madh.
Numrit nga ana e djathtë i shkruhet zero.
- shifra e njësheve bëhet shifra e dhjetësheve
- shifra e dhjetësheve bëhet shifra e qindësheve

Q	DH	NJ
	1	2
1	2	0

$\cdot 10$

Të përkujtohemi!

Shumëzimi i numrit dyshifror me zbërthim.

$16 \cdot 10 = (10 + 6) \cdot 10 =$
$= 10 \cdot 10 + 6 \cdot 10 =$
$= 100 + 60 =$
$= 160$

$63 \cdot 10 =$

$87 \cdot 10 =$

1 **Njehso:**

a) $15 \cdot 10 =$ b) $43 \cdot 10 =$ c) $26 \cdot 10 =$

ç) $94 \cdot 10 =$ d) $61 \cdot 10 =$ dh) $10 \cdot 17 =$

2 **Shumën e numrave 42 dhe 23 zmadhoje 10 herë.**

Zgjidhje:

3 Shkruaj numrat të cilët mungojnë.



4 Një pushimore fëmijësh ka dy kate. Në çdo kat ka nga 10 dhoma. Te kati i parë dhomat janë me nga 12 shtretër, kurse te kati i dytë me nga 13 shtretër. Sa nxënës më së shumti mund të qëndrojnë në pushimore në të njëjtën kohë?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

5 Në një tren ka 48 udhëtarë. Nëse në atë tren ka 10 herë më shumë vende prej numrit të udhëtarëve, njehso sa vende të zbrazura ka te treni?

Zgjidhje:

Përgjigje: _____

SHUMËZIMI I NUMRAVE PREJ DHJETËSHES SË DYTË ME 1, 2, 3, 4 DHE 5

Të përkujtohemi!

Ema ka bërë 4 buketa me lule. Në çdo buketë ka vendosur nga 12 lule. Sa lule gjithsej la venduar Ema në të gjitha buketat?

12 · 4 =

Përgjigje:
Ema në të gjithë buketët ka venduar ____ lule.

Mbaj mend!

DH	NJ
1	2
	4
4	8

·

Shumëzimi në shtylla

Shumëzimin e fillojmë prej njësheve të numrit 12.

4 · 2NJ = 8NJ
8 shkruajmë nën shifrat e njësheve

